



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 18

2000

Korrik

### P Ë R M B A J T J A

|                                       |                                                                                                                                                                                                                   |     |
|---------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Ligj nr. 8618,<br>datë 14.6.2000      | Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë                                                                                                                                                                 | 835 |
| Ligj nr.8623,<br>datë 15.6.2000       | Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar" | 867 |
| Ligj nr.8624,<br>datë 15.6.2000       | Për aderimin në "Konventën e Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit"                                                                                                       | 872 |
| Ligj nr.8625,<br>datë 15.6.2000       | Për caktimin e "Ditës së Triumfit të Paqes"                                                                                                                                                                       | 883 |
| Vendim i KM<br>Nr.313, datë 13.6.2000 | Për funksionimin e Drejtorisë së Patentave dhe Markave                                                                                                                                                            | 884 |
| Vendim i KM<br>Nr.315, datë 23.6.2000 | Për krijimin dhe funksionimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe Trajnimit të Nëpunësimit Civil                                                                                               | 885 |
| Vendim i KM<br>Nr.319, datë 23.6.2000 | Për shfuqizimin e Vendimit nr.433, datë 3.9.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për ndalimin e importimit të gomave të përdorura"                                                                                  | 888 |

|                                       |                                                                                                                                                                                                                    |     |
|---------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Vendim i KM<br>Nr.325, datë 23.6.2000 | Për krijimin e Qendrës Kombëtare "Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve", si njësi buxhetore e veçantë                                                                                          | 889 |
| Vendim i KM<br>Nr.329, datë 23.6.2000 | Për financimin në vitin 2000, të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit                                                                                                                                | 890 |
| Vendim i Gj.K Nr.32                   | Me objekt: "Shfuqizimin si antikushtetues i pikës 1 të Vendimit nr.46, datë 17.2.2000 të Këshillit të Ministrave "Për shkarkimin nga detyra të kryetarëve të Komunave Ksamil, Helmas dhe Kurjan"                   | 890 |
| Vendim i Gj.K Nr.33                   | Me objekt: " Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.282, datë 23.6.1999, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë"                                                                                             | 894 |
| Vendim i Gj.K Nr.37                   | Me objekt: "Interpretimi i neneve 69 pikat, 1/d e 2; 70/2 dhe 179, pika 1 e 4 e Kushtetutës"                                                                                                                       | 897 |
| Vendim i Gj.K Nr.38                   | Me objekt: "Interpretimi i nenit 103/3 të Kushtetutës së Shqipërisë"                                                                                                                                               | 899 |
| Vendim i Gj.K Nr.39                   | Me objekt: "Interpretimin e nenit 73/2 të Kushtetutës"                                                                                                                                                             | 901 |
| Vendim i Gj.L Nr.686                  | Me objekt: "Detyrimin e anës së paditur të trajtojë me tokë bujqësore, sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për Tokën", si një e drejtë e njohur me ligj që nuk mund të çënohet pa një proces të rregullt ligjor" | 905 |
|                                       | Kërkesë për Shpallje të zhdukur të Mehmet Reçaj                                                                                                                                                                    | 909 |
|                                       | Kërkesë për Shpallje të vdekur të Shpëtim Cacaj                                                                                                                                                                    | 909 |
|                                       | Kërkesë për Shpallje të vdekur të Xhemal Ahmet Shahinit                                                                                                                                                            | 910 |
|                                       | Kërkesë për Shpallje të vdekur të Petrit Aliaj                                                                                                                                                                     | 911 |
|                                       | Kërkesë për Shpallje të vdekur të Vahide Koçi                                                                                                                                                                      | 911 |

**L I G J**  
**Nr.8618, datë 14.6.2000**

**PËR TELEKOMUNIKACIONET NË REPUBLIKËN  
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

**K R E U I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Qëllimi**

Ky ligj rregullon veprimtarinë e telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë dhe synon të mbrojë interesat publikë dhe të krijojë një mjedis rregullator transparent, që ndihmon nxitjen e investimeve dhe konkurrencën e lirë.

Neni 2

**Përkufizime**

Për zbatimin e këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrimi i spektrit" është veprimtaria teknike, administrative dhe juridike për një përdorim të frytshëm të spektrit të radiofrekuencave në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. "Aksesi në Internet" është shërbimi, i cili mundëson aksesin në rrjetin dhe shërbimet e Internetit.
3. "Interkoneksion" është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të telekomunikacioneve që përdoruesit e shërbimeve publike të telekomunikacioneve të një operatori publik telekomunikacionesh, të lidhen ose të komunikojnë me përdoruesit e shërbimeve publike të telekomunikacioneve të një operatori tjetër publik telekomunikacionesh.
4. "Linjë me qira" është një shërbim telekomunikacioni, i cili ka të bëjë me vendosjen nga operatori publik i telekomunikacioneve, i linjave të palëvizshme, të përhershme, permanente ose virtuale, ndërmjet pikave fundore të rrjetit për përdorim vetëm nga një përdorues individual, kundrejt një pagese.
5. "Ministër" është Ministri që mbulon sektorin e telekomunikacioneve, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve.
6. "Numërorator telefonik" është botimi i librit të numrave telefonikë të abonentëve të një operatori publik, si dhe i adresave të tyre.
7. "Numra" janë sekuenca karakteresh që shërbejnë për adresim në rrjetet e telekomunikacioneve.
8. "Operator i pavarur i telekomunikacioneve" është subjekti, të cilit i është dhënë një licencë për të ngritur një rrjet të pavarur telekomunikacionesh për realizimin e komunikimeve vetëm brenda një ose disa grupeve të mbyllura përdoruesish.
9. "Operator publik i telekomunikacioneve" është subjekti, të cilit i është dhënë licencë për të ndërtuar e shfrytëzuar një rrjet publik telekomunikacionesh dhe/ose për të ofruar shërbime publike telekomunikacionesh.
10. "Operator" është subjekti, të cilit i është dhënë licenca, në bazë të dispozitave të këtij ligji.

11. “Organizëm me fuqi të ndjeshme në treg” është subjekti që autorizohet të ofrojë rrjete publike telefonike dhe/ose shërbime publike telefonike, të qëndrueshme (të palëvizshme) dhe/ose të lëvizshme dhe/ose linja me qira në Republikën e Shqipërisë, i cili është përcaktuar si i tillë nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

12. “Pajisje fundore” është çdo pajisje në përdorim të abonentit që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthoraz në një pikë fundore të rrjetit të telekomunikacioneve, për të realizuar telekomunikacionet. Pajisja fundore mund të lidhet me rrjetin nëpërmjet përcjellësve metalikë, optikë ose nëpërmjet kablllove koaksiale dhe, në këtë rast, quhet e palëvizshme. Nëse pajisja lidhet me rrjetin me mjete radioelektrike, ajo quhet e lëvizshme.

13. “Pajisje radiokomunikacioni” janë pajisjet për transmetimin, emetimin ose marrjen e radiovalëve për qëllime radiokomunikimi.

14. “Pajisje telekomunikacioni” është çdo mjet teknik (linjë transmetimi, pajisje komutimi dhe çdo pajisje tjetër, e nevojshme për të siguruar funksionimin e rrjetit të telekomunikacioneve) që shërben për realizimin e telekomunikacioneve.

15. “Përdorues” është çdo person fizik ose juridik, që përdor shërbime publike telekomunikacionesh.

16. “Pika fundore të rrjetit” janë të gjitha lidhjet fizike, së bashku me specifikimet e tyre teknike, të cilat janë pjesë e rrjetit publik të telekomunikacioneve dhe shërbejnë për aksesin në këtë rrjet publik dhe realizimin e komunikimit nëpërmjet tij.

17. “Plan kombëtar i radiofrekuencave” është dokumenti që përcakton brezat e radiofrekuencave për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e radiofrekuencave, me qëllim përdorimin me efektivitet të spektrit të radiofrekuencave dhe shmangien e interferencave.

18. “Radiokomunikacion” është telekomunikacioni i realizuar nëpërmjet radiovalëve.

19. “Rregullim” janë masat e ndërmarra për të arritur objektivat e shprehur në nenin 3 të këtij ligji dhe për të siguruar përdorimin e frytshëm dhe pa interferenca të radiofrekuencave.

20. “Rrjet i pavarur ose i brendshëm telekomunikacionesh” është një rrjet telekomunikacionesh i caktuar për përdorim nga një ose disa persona fizikë a juridikë, që përbëjnë një ose disa grupe të mbyllura përdoruesish dhe për të realizuar vetëm komunikime brenda grupit.

21. “Rrjet i telekomunikacioneve” është tërësia e mjeteve teknike (linja transmetimi, pajisje komutimi dhe çdo pajisje tjetër, e nevojshme për të siguruar funksionimin e rrjetit të telekomunikacioneve), të cilat shërbejnë për realizimin e telekomunikacioneve.

22. “Rrjet publik i telekomunikacioneve” është një rrjet telekomunikacionesh i përdorur, ndërmjet të tjerash, për ofrimin e shërbimeve publike të telekomunikacioneve.

23. “Shërbim global i komunikimeve vetjake të lëvizshme” është shërbimi telefonik i lëvizshëm, i cili realizohet nëpërmjet lidhjes së drejtpërdrejtë të pajisjes fundore, të lëvizshme, të përdoruesit me një sistem satelitor. Njihet edhe me emërtimin GMPCS.

24. “Shërbim informacioni” është dhënia e informacionit për përdoruesit e shërbimeve të rrjetit publik, i cili ofrohet me kërkesën e çdo personi, nëpërmjet rrjetit të telekomunikacioneve.

25. “Shërbim publik i telekomunikacioneve” është ofrimi që i bëhet publikut, për qëllime fitimi, i telekomunikacioneve, si dhe linjat me qira që u ofrohen palëve të treta.

26. “Shërbim publik telefonik i lëvizshëm tokësor” është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, nëpërmjet një rrjeti publik telekomunikacionesh, pikat fundore të të cilit nuk janë në vendndodhje të qëndrueshme, duke i dhënë mundësi përdoruesve të komunikojnë brenda zonave të mbuluara nga ky shërbim, pavarësisht nga vendndodhja.

27. “Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm (i palëvizshëm)” është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, pajisjet fundore të të cilëve lidhen në pikat fundore me vendndodhje të qëndrueshme të rrjetit publik të telekomunikacioneve.

28. “Shërbim publik telefonik” është ofrimi ndaj publikut, për qëllime fitimi, i transportimit dhe komutimit të drejtpërdrejtë e në kohë reale të zërit, ndërmjet pikave fundore të rrjetit publik me komutim, duke i dhënë mundësi çdo përdoruesi të përdorë pajisjet e lidhura në këto pika fundore rrjeti, për të komunikuar me një pikë tjetër fundore.

29. “Shërbim universal” është një grup minimal i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i cili është i mundshëm për të gjithë shtetasit, pavarësisht nga pozicioni gjeografik dhe që

ofrohet me çmime të përballueshme.

30. “Shërbimi i transmetimit të të dhënave” është ofrimi tregtar për publikun, i transportimit të drejtpërdrejtë të të dhënave, ndërmjet pikave fundore të rrjetit publik me komutim, duke i dhënë mundësi çdo përdoruesi të përdorë pajisjet e lidhura me një pikë të tillë fundore rrjeti, për të komunikuar me një pikë tjetër fundore.

31. “Shërbimi me vlerë të shtuar” është shërbimi në kohë reale i bazave të të dhënave videotekst, shërbimet e informacionit, përpunimi në largësi i të dhënave, posta elektronike, shërbimet transaksionale, konvertimi i shpejtësisë dhe i protokolleve.

32. “Shërbimi radio i kërkit të personit (paging)” është veprimtaria tregtare e komunikimit të teksteve të shkurtra ose e sinjalizimeve akustike, nëpërmjet një terminali të veçantë, të lëvizshëm.

33. “Sistem radiokomunikacioni” është një ose disa dhënës ose marrës, ose një ndërthurje dhënësish e marrësish, përfshirë pajisjet e tyre ndihmëse, të nevojshme në një vendvendosje të caktuar për realizimin e një shërbimi radiokomunikacioni ose të një shërbimi radioastronomik.

34. “Spektri i radiofrekuencave” është spektri që përfshin frekuencat prej 9KHz deri në 400 GHz.

35. “Standard ndërkombëtar” është standardi i miratuar nga organizmat ndërkombëtarë, si ITU-ja, CEPT-ja, ku aderohet Republika e Shqipërisë.

36. “Telekomunikacion” është emetimi, dhënia ose marrja e mesazheve në formën e shenjave, të zërit, të figurave ose të tingujve, nëpërmjet rrjeteve të telekomunikacioneve, por që nuk përfshin transmetimin radioteleviziv.

37. “Transmetim radioteleviziv” është shpërndarja e sinjaleve radiotelevizive për publikun, nëpërmjet transmetimit të valëve elektromagnetike, në hapësirë ose në një infrastrukturë kablllore.

#### Neni 3

### **Objektivat afatgjatë të politikës**

Objektivat afatgjatë të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë janë zhvillimi i harmonizuar i infrastrukturës së telekomunikacioneve dhe shtrirja graduale e saj në të gjithë vendin, me qëllim që të arrihet:

- a) akses në shërbimet telefonike me çmime të përballueshme;
- b) gamë e gjerë shërbimesh moderne, e cila të jetë e përdorueshme nga e gjithë popullsia e Republikës së Shqipërisë;
- c) liberalizim i tregut, konkurrencë shërbimesh dhe mundësi zgjedhjeje për përdoruesit ;
- ç) mbrojtje më e mirë e përdoruesit.

#### KREU II

### **ROLI I SHTETIT NË TELEKOMUNIKACIONE**

#### Neni 4

### **Përcaktimi i politikave të zhvillimit dhe të rregullimit të sektorit të telekomunikacioneve**

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit, përcakton strategjinë e zhvillimit të telekomunikacioneve brenda kuadrit të vendosur nga ky ligj.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator të përcaktuar nga ky ligj dhe nga politikat e Këshillit të Ministrave.

#### Neni 5

### **Vendimet për zbatimin e politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve**

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit dhe në këshillim me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve dhe shoqatat e konsumatorëve, ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve.

## Neni 6

### **Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve**

Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve është person juridik, publik, buxhetor dhe punon për përmbushjen e objektivave të strategjisë së telekomunikacioneve.

Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve varet nga Ministri, i cili ka në kompetencë veprimtarinë në fushën e telekomunikacioneve.

## Neni 7

### **Kompetencat e Drejtorisë të Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve**

Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve ka këto kompetenca:

- a) Harton projektaktet ligjore e nënligjore për zhvillimin e sektorit të telekomunikacioneve.
- b) Bashkërendon punën për hartimin e planit kombëtar të radiofrekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare të zhvillimit të spektrit të radiofrekuencave.
- c) Bashkërendon punën për realizimin e nevojave të institucioneve shtetërore, si të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Shërbimit Informativ të Shtetit, etj.
- ç) Mbledh e përpunon të dhëna statistikore nga të gjithë operatorët publikë të telekomunikacioneve në vend.
- d) Ndjek zbatimin e detyrimeve për sektorin e telekomunikacioneve, që rrjedhin nga marrëveshjet, konventat ose protokollet dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe, ku Republika e Shqipërisë është palë.
- dh) Bashkërendon shërbimet kombëtare të radiondërlidhjes bregdetare.
- e) Mbështet veprimtarinë e radioamatorizmit në Republikën e Shqipërisë.
- ë) Bashkëpunon me organet e pushtetit vendor për çështje të telekomunikacioneve.
- f) Bashkërendon punën për zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin e telekomunikacioneve.
- g) Harton plane zhvillimi të telekomunikacioneve dhe i paraqet Ministrit rekomandimet përkatëse.

## Neni 8

### **Enti Rregullator i Telekomunikacioneve**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve është organi rregullator i telekomunikacioneve, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj dhe nga politikat e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

## Neni 9

### **Kompetencat e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ka këto kompetenca:

- a) Nxiti zhvillimin e sektorit të telekomunikacioneve, duke zbatuar procedurat e licencimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
- b) Jep licencat në bazë të përcaktimeve të këtij ligji dhe mbikëqyr respektimin e kushteve të licencave.
- c) Rregullon interkoneksionin e rrjeteve të telekomunikacioneve.
- ç) Kontrollon cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët dhe kërkon që ato të përputhen me standardet e caktuara.
- d) Kujdeset që konkurrenca ndërmjet operatorëve të telekomunikacioneve të mbështetet në parimet e transparencës, të mosdiskriminimit dhe të ndërshtetërisë.
- dh) Harton dhe miraton planin kombëtar të numëracionit dhe siguron zbatimin e tij.
- e) Mbron interesat e përdoruesve të shërbimeve të telekomunikacioneve nga praktikat e pandershme të operatorëve.
- ë) Verifikon njëllojshmërinë e pajisjeve të importuara të telekomunikacioneve dhe bën

përshtatjen e atyre që prodhohen në vend.

f) Harton dhe miraton kushtet dhe standardet teknike për rrjetet e telekomunikacioneve, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare.

g) Cakton radiofrekuencat për çdo përdorues civil, me përjashtim të operatorëve radio dhe televizivë, duke dhënë licencën përkatëse dhe merr masa për mënjanimin e interferencave, gjetjen e shkeljeve dhe mënjanimin e përdorimeve abuzive të frekuencave.

gj) Mbikëqyr bazueshmërinë me kërkesat e këtij ligji të tarifave të ofruara nga operatorët publikë të telekomunikacioneve.

Aktet e nxjerra prej Entit Rregullator të Telekomunikacioneve botohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

### KREU III RRJETET DHE SHËRBIMET E TELEKOMUNIKACIONEVE

#### Neni 10

##### **Rrjetet e telekomunikacioneve**

Rrjeti publik i telekomunikacioneve ndërtohet për të mbështetur shërbimet publike të telekomunikacioneve dhe funksionon si rrjet mbarëkombëtar, pa dallim, për të gjithë përdoruesit, i hapur për të gjithë operatorët dhe i integruar në rrjetin ndërkombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Rrjetet e pavarura të telekomunikacioneve ndërtohen dhe mirëmbahen nga subjekte të licencuara, për të plotësuar nevojat e tyre. Lidhja me rrjetin publik të telekomunikacioneve bëhet në marrëveshje me operatorët.

Vendosja e rrjeteve të reja të telekomunikacioneve bëhet nga subjekte të licencuar, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

#### Neni 11

##### **Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet**

Operatori i telekomunikacioneve mban dokumentacion të plotë e të saktë, për rrjetin e vet. Me kërkesë zyrtare, operatorët i japin njëri-tjetrit dhe sipërmarrësve të tjerë të dhëna për pjesë të këtij rrjeti, për të shmangur dëmtimin e rrjetit nga punimet nëntokësore ose ndërtimore ose nga ndikimet e mundshme elektrike, që shkakton vënia në punë e pajisjeve të vendosura pranë rrjetit të telekomunikacioneve.

#### Neni 12

##### **E drejta e përdorimit të pronës publike e private**

Operatori publik i telekomunikacioneve ka të drejtë të përdorë tokë, troje ose objekte në pronësi të shtetit, përfshirë ndërtesat e kanalizimet e ndërtuara mbi ose nën to, të drejtat nënujore dhe ato të hapësirës ajrore, rrugët, liqenet, pyjet etj., për vendosjen e pajisjeve të telekomunikacioneve, si dhe për mirëmbajtjen e tyre.

Para fillimit të punimeve në trojet ose në mjediset me pronësi publike, operatorët publikë të telekomunikacioneve duhet të njoftojnë autoritetet përkatëse dhe të respektojnë të gjitha kërkesat e arsyeshme, të vendosura nga to. Mosmarrëveshjet ndërmjet operatorit publik të telekomunikacioneve dhe autoritetit përkatës zgjidhen nga gjykata.

Operatori detyrohet të shfrytëzojë pronat e mësipërme, në përputhje me ligjet që mbrojnë mjedisin dhe, me përfundimin e punimeve, kur është objektivisht e mundur, detyrohet ta kthejë mjedisin në gjendjen e mëparshme.

Operatori publik i telekomunikacioneve përdor tokën, trojet dhe objektet pronë private, në marrëveshje me pronarët e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kur nga vendosja ose mirëmbajtja e pajisjeve të telekomunikacioneve dëmtohet prona ose ndryshon funksioni i saj, operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet të shpërblejë dëmin, sipas

legjislacionit në fuqi.

#### Neni 13

##### **Detyrimi i operatorit për mirëmbajtje**

Operatori i telekomunikacioneve detyrohet të mbajë pajisjet e telekomunikacioneve në gjendje të mirë pune, duke respektuar kushtet teknike dhe standardet përkatëse.

Gjatë përmbushjes së detyrave për mirëmbajtjen e pajisjeve të telekomunikacioneve, punonjësit e autorizuar nga operatori kanë të drejtë të hyjnë në pronat publike dhe private, për të kryer punimet e nevojshme, si dhe për të vënë shenja të ndryshme, që tregojnë praninë e objekteve të telekomunikacioneve.

Për të siguruar funksionimin normal të pajisjeve të telekomunikacioneve, operatori ka të drejtë të presë pemët, shkurret, degët e rrënjët që rrezikojnë pajisjet e mësipërme, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast se pronari privat bëhet pengesë, operatori u drejtohet organeve kompetente, të cilat marrin masat e nevojshme brenda 15 ditëve.

#### Neni 14

##### **Mbrojtja e rrjetit nga dëmtimet e të tretëve**

Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të rrjetit ekzistues të telekomunikacioneve, çdo person fizik ose juridik që kryen punime ndërtimi e gërmimi, përpara fillimit të punimeve detyrohet të njoftojë operatorët publikë të telekomunikacioneve.

Në rast se punimet në rrjetin ekzistues të telekomunikacioneve duhet të kryhen në mënyrë të pashmangshme, të gjitha shpenzimet për mbrojtjen, shmangien ose dëmtimin e këtyre rrjeteve të përballohen nga subjekti që kryen punimet.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen nga gjykata.

#### Neni 15

##### **Detyrime për sipërmarrësit ndërtues**

Në rastet e ndërtimit të godinave për qëllime biznesi ose të godinave të banimit, sipërmarrësit ndërtues detyrohen të ndërtojnë rrjetin e brendshëm telefonik.

#### Neni 16

##### **Standardet e pajisjeve të telekomunikacioneve**

Në rrjetin publik të telekomunikacioneve mund të vendosen vetëm pajisje, të cilat kanë karakteristika teknike sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë të telekomunikacioneve, ku aderon Republika e Shqipërisë.

#### Neni 17

##### **Organizmi me fuqi të ndjeshme në treg**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton nëse një operator është organizëm me fuqi të ndjeshme në treg. Një operator vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse ai kontrollon 25 për qind të tregut të zonës gjeografike, ku ky organizëm është i autorizuar të veprojë.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të vlerësojë si organizëm me fuqi të ndjeshme në treg edhe një operator që zotëron më pak se 25 për qind të tregut përkatës, si dhe mund të mos ta vlerësojë si organizëm me fuqi të ndjeshme në treg, një operator që zotëron më shumë se 25 për qind të tregut përkatës. Në raste të tilla, në arritjen e këtyre përcaktimeve, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mban parasysh aftësinë e organizmit për të ndikuar në treg, të ardhurat e tij në raport me madhësinë e tregut, kontrollin mbi mjetet e aksesit të përdoruesit fundor dhe përvojën e operatorit në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve në treg.



#### Neni 18

##### **Detyrat e operatorit për ofrimin e shërbimit**

Operatori publik i telekomunikacioneve, në zonën ku ushtron veprimtarinë, ka këto detyra:

- a) T'u ofrojë shërbime dhe pajisje telekomunikacioni përdoruesve dhe operatorëve të tjerë, pa bërë favorizime ose diskriminim, kur është organizëm me fuqi të ndjeshme në treg.
- b) Të vijojë trafikun drejt/nga operatorët e tjerë dhe të mirëmbajë e të zhvillojë rrjetet publike të telekomunikacioneve që administrojnë.
- c) Të bashkëveprojë me operatorët e tjerë publikë për:
  - (i) këmbimin e ndërsjellë të informacionit dhe bashkërendimin e të dhënave teknike për bashkëpunimin e rrjeteve të tyre;
  - (ii) kryerjen e matjeve të parametrave të shfrytëzimit të sistemit;
  - (iii) harmonizimin e sistemeve të mirëmbajtjes, bashkërendimin e punës për mirëmbajtjen e sistemeve;
  - (iv) riparimin e defekteve.
- ç) Të kontribuojë në çështjet e mbrojtjes të rendit publik dhe të sigurimit kombëtar.
- d) Të zbatojë kushtet e licencës.

#### Neni 19

##### **Detyrimi i operatorit për të informuar**

Operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet t'i japë të dhëna statistikore Drejtorisë së Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Lloji i të dhënave, afatet dhe mënyra e dërgimit të tyre përcaktohen përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve dhe nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

#### Neni 20

##### **Detyrimi i operatorit për mbrojtjen kombëtare dhe rendin publik**

Operatori publik i telekomunikacioneve i jep përparësi çështjeve të mbrojtjes kombëtare dhe të rendit publik, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me kushtet e licencës.

#### Neni 21

##### **Marrëdhëniet e punës**

Marrëdhëniet e punës, ndërmjet operatorit publik të telekomunikacioneve dhe punonjësve të tij, rregullohen nga dispozitat ligjore të punës.

#### Neni 22

##### **Ruajtja e fshehtësisë**

Operatori publik i telekomunikacioneve duhet të marrë masa ndaj sistemeve të telekomunikacioneve dhe të përpunimit të të dhënave për të mbrojtur sekretin e telekomunikacioneve dhe të të dhënave vetjake, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e telekomunikacioneve dhe të përpunimit të të dhënave.

Operatori publik i telekomunikacioneve, të autorizuarit, si dhe punonjësit e tij detyrohen të ruajnë e mbrojnë të dhënat dhe fshehtësinë e komunikimeve që kryhen nëpërmjet rrjetit dhe shërbimeve të tij, si gjatë periudhës së licencës, ashtu edhe pas mbarimit të saj.

Operatori publik mund të marrë dijeni për mesazhe ose të dhëna të transmetuara nëpërmjet rrjetit të tij, vetëm në masën që i nevojitet për të kryer detyrën në sigurimin e shërbimeve të telekomunikacioneve.

Ndalohet marrja, regjistrimi, publikimi dhe përdorimi i të dhënave dhe i mesazheve që janë transmetuar nga rrjeti i telekomunikacioneve dhe që nuk janë për publikun.

Neni 23  
**Sekreti profesional**

Ndalohet riprodhimi i sinjaleve që nuk përfshihen në kushtet e licencës, përdorimi i tyre për qëllime të tjera, deklarimi i ekzistencës ose dhënia e tyre personave të paautorizuar.

Neni 24  
**Detyrimi për dhënie informacioni autoriteteve shtetërore**

Pavarësisht nga neni 22 i këtij ligji, për kryerjen e hetimeve penale, operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet të mbajë skedarët e të dhënave për përdoruesit e shërbimeve të tyre, kur një gjë e tillë kërkohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ose nga çdo autoritet tjetër, i përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale. Skedarët duhet të përmbajnë vetëm hollësi për numrat e thirrur nga përdoruesi, datën dhe kohën e çdo thirrjeje edhe në rastet kur numri nuk është i publikuar në numërorin telefonik.

Këta skedarë duhet t'u vihen në dispozicion autoriteteve përkatëse, në formë elektronike, në përputhje me udhëzimet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Neni 25  
**Përgjimi i komunikacioneve**

Pavarësisht nga neni 22 i këtij ligji, operatori publik i telekomunikacioneve duhet t'i lejojë organet e autorizuar, me ligj të veçantë, për të përgjuar, regjistruar dhe riprodhuar komunikimet e kryera në rrjetin e tij, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe me rregulloren e nxjerrë në mbështetje të nenit 57.

Pajisjet e vendosura ose të lidhura me rrjetin e një operatori publik telekomunikacionesh për përgjimin e bisedave telefonike duhet të jenë kompatibël me sistemin e telekomunikacioneve dhe nuk duhet të krijojnë interferenca me sisteme të tilla.

Neni 26  
**Detyrimet parësore të operatorit në raste të veçanta**

Operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet që, me rrjetet dhe shërbimet e tij, të përballojë nevojat e shtetit në rast emergjence, fatkeqësish natyrore dhe kur e kërkojnë interesat e mbrojtjes kombëtare e të rendit publik.

Detyrimet e mësipërme mund të përcaktohen në kushtet e licencës ose mund të vendosen, rast pas rasti, nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Operatorët e telekomunikacioneve bashkëveprojnë ndërmjet tyre dhe me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe joqeveritare për përdorimin e burimeve të telekomunikacioneve për lehtësimin dhe kapërcimin e fatkeqësive:

a) duke vendosur pajisje të komunikimit tokësor dhe satelitor për parandalimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e parandalimit të shkatërrimeve natyrore, fatkeqësive në përgjithësi e atyre shëndetësore në veçanti;

b) duke shpërndarë njoftime për shkatërrimet natyrore, fatkeqësitë shëndetësore ndërmjet organizmave të lidhura me to dhe përhapjen e të dhënave në publik, veçanërisht në bashkësitë që rrezikohen më tepër;

c) duke siguruar ndihmë të menjëhershme të telekomunikacioneve, për lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë;

ç) duke vendosur dhe vënë në punë shërbimet e telekomunikacioneve fleksible, që përdorin organizatat humanitare.

Për lehtësimin e përdorimit të mësipërm, operatorët e telekomunikacioneve mund të lidhin marrëveshje të veçanta dhe të vendosin pagesa të veçanta ose të nënshkruajnë shtesa në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 27  
**E drejta për pajtim**

Cilido ka të drejtë të pajtohet dhe të përdorë shërbimet publike të telekomunikacioneve, në rast se ato janë të pranishme përrreth zonës ku ka vendbanimin ose ushtron veprimtarinë.

Neni 28  
**Të drejtat dhe detyrat e përdoruesve**

Çdo përdorues i shërbimeve telefonike publike ka të drejtë të përdorë rrjetet publike të telekomunikacioneve, për trafikun kombëtar e ndërkombëtar, në kushte jodiskriminuese, objektive dhe transparente, me përjashtim të rasteve kur diktohet ndryshe nga mundësitë e kufizuara të mjeteve të operatorit publik.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike kanë të drejtë të marrin shërbim të rregullt, të frytshëm dhe të pandërprerë.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike kanë të drejtë të kërkojnë sqarime e të bëjnë ankesa për shërbimin që u ofrohet, të cilat duhet të shqyrtohen e të zgjidhen në mënyrë të frytshme.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike i përdorin shërbimet kundrejt pagesës.

Përdoruesit e shërbimeve telefonike publike detyrohen të kujdesen dhe të mirëmbajnë pajisjet e tyre fundore për të mbrojtur rrjetin.

Neni 29  
**Kontrata e pajtimit**

Për përdorimin e shërbimeve telefonike publike, operatori i shërbimeve telefonike publike lidh kontratën me përdoruesit.

Kontrata tip, që lidhet ndërmjet operatorit dhe përdoruesit, duhet të mbështetet në parimin e barazisë kontraktore të palëve. Ajo hartohet nga operatori dhe miratohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Neni 30  
**Faturimi**

Operatori i shërbimeve telefonike publike duhet të garantojë saktësi në vënien e tarifës dhe në faturimin për shërbimet e kryera prej tij. Për të vërtetuar saktësinë e tarifës dhe të faturimit, operatori i shërbimeve telefonike publike duhet të ruajë kopje të faturave, të paktën deri në dy vjet.

Faturimi bëhet në mënyrë periodike, sipas përcaktimit në kontratë dhe përdoruesi i shërbimit njoftohet për detyrimin financiar të tij, brenda një muaji nga data e faturimit.

Operatori i shërbimeve telefonike publike i jep pa pagesë çdo përdoruesi të tij një faturë, e cila përmban elementet bazë që lejojnë verifikimin dhe kontrollin e tarifës e të faturimit. Elementet bazë të kësaj fature përcaktohen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Me kërkesë të përdoruesit, operatori i shërbimeve telefonike publike duhet të sigurojë shërbimin me fature të hollësishme, kundrejt një pagese të arsyeshme.

Neni 31  
**Trajtimi për shërbime të ndryshme nga ato të telefonisë publike**

Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton se një operator ka fuqi të ndjeshme në treg për shërbime të ndryshme nga ato të telefonisë publike, ai ka të drejtë të vendosë nëse ato shërbime u nënshtrohen, pjesërisht apo tërësisht, kërkesave të neneve 28, 29, 30 të këtij ligji.

Neni 32  
**Detyrimi i operatorëve për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit**

Operatorët e telekomunikacioneve detyrohen të marrin të gjitha masat për mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve të rrjeteve të telekomunikacioneve dhe të personave që janë të ekspozuar ndaj këtyre rrjeteve, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

#### Neni 33

### **Detyrimi për të siguruar cilësinë e shërbimit**

Operatorët publike të telekomunikacioneve duhet t'u sigurojnë përdoruesve të tyre shërbime të standardeve cilësore, të miratuara në të gjithë territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Në raste të veçanta, përdoruesi mund të lidhë kontratë me operatorin për cilësi me të lartë shërbimi, kundrejt pagesës.

#### Neni 34

### **Detyrimi për botimin e numërorëve**

Operatori, i cili zotëron pjesën më të madhe të tregut të telefonisë së palëvizshme, detyrohet të botojë numëror shërbimi, të paktën një herë në vit. Operatorët e tjerë publikë të telekomunikacioneve duhet të marrin masat për t'i dhënë këtij operatori të dhënat e duhura për përdoruesit e shërbimeve të tij, me qëllim që të dhënat e numërorit të përgatitur për botim të pasqyrohen saktë. Numërori i shërbimit përmban edhe telefonat publikë, me monedhë ose me kartë të parapaguar.

Përdoruesit kanë të drejtë t'u publikohen të dhënat në numërorë, të verifikojnë dhe, nëse është e nevojshme, të korrigjojnë të dhënat ose të kërkojnë heqjen e tyre nga numërorët.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të sigurojë që operatori, i cili ofron shërbimin e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, të respektojë parimet e mosdiskriminimit në trajtimin dhe në paraqitjen e të dhënave.

#### Neni 35

### **Shërbimi i të dhënave**

Operatori publik i telekomunikacioneve, i cili ofron shërbim telefonik, është i detyruar të ofrojë shërbimin e të dhënave për të gjithë përdoruesit e vet.

Operatori publik i telekomunikacioneve, i cili ofron shërbim telefonik, duhet të ofrojë shërbimin e të dhënave edhe për përdoruesit e pajtuar pas publikimit të numërorit të fundit telefonik, nëpërmjet centralistes ose në formë tjetra.

Të dhënat në dispozicion të këtij shërbimi duhet të azhurnohen çdo muaj.

#### Neni 36

### **Ofrimi i të dhënave të klientëve**

Për të ofruar shërbimin e të dhënave për publikun ose të publikimit të numërorëve telefonikë, operatori që ofron shërbime publike të telefonisë zanore duhet t'u japë të licencuarve të tjerë, të cilët ofrojnë shërbime të ngjashme me kërkesën e tyre dhe në një formë të përshtatshme për t'u përdorur, akses në të dhënat e përdoruesve, duke mbikëqyrur zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

Në këto raste, pagesa bazohet në koston që nevojitet për sigurimin e një shërbimi të frytshëm.

#### Neni 37

### **Shërbimet e urgjencës**

Operatori publik i telekomunikacioneve, i cili ofron shërbime telefonike, duhet të sigurojë falas shërbimet e urgjencës. Shërbimi i urgjencës është vijimi i thirrjeve drejt numrave të shkurtër, të caktuar për organet përkatëse të shërbimeve të urgjencës si:

- a) forcat e policisë së shtetit;
- b) forcat e mbrojtjes nga zjarri;

c) ndihma e shpejtë mjekësore.

Neni 38

### **Shërbimi i përgjithshëm**

Këshilli i Ministrave bën klasifikimin dhe përcakton detyrimet për shërbimin e përgjithshëm në kuadër të politikave të zhvillimit të telekomunikacioneve, të cilat duhet të synojnë që shërbimet të jenë të disponueshme dhe me çmime të përballueshme për të gjithë përdoruesit në territorin e tyre, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike.

Shteti zbaton një politikë të veçantë për përballimin e shërbimeve telefonike në zonat rurale ose në zona me kosto të lartë, si dhe nga përdorues me aftësi të kufizuar ose me nevoja të veçanta shoqërore.

Detyrimet e operatorit për shërbimin e përgjithshëm, të përcaktuara në kushtet e licencës, derdhen në fondin e shërbimit të përgjithshëm, i cili administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve.

KREU IV

## **SIGURIMI I RRJETIT TË HAPUR DHE INTERKONEKSIONI**

Neni 39

### **Kërkesat thelbësore për sigurimin e rrjetit të hapur**

Operatorët, për të garantuar funksionimin e frytshëm të rrjeteve dhe të shërbimeve të telekomunikacioneve, janë të detyruar të plotësojnë këto kërkesa thelbësore:

- a) sigurimin e funksionimit të rrjetit;
- b) ruajtjen e tërësisë së rrjetit;
- c) bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve,
- ç) mbrojtjen e të dhënave.

Neni 40

### **Parimet bazë të sigurimit të rrjetit të hapur**

Parimet dhe kushtet e harmonizuara për sigurimin e rrjetit të hapur duhet të mbështeten në kritere objektive, të jenë transparente dhe të publikuara në mënyrën e duhur, të garantojnë akses të barabartë dhe të mos jenë diskriminuese.

Neni 41

### **Ndërfaqet për sigurimin e rrjetit të hapur**

Për sigurimin e rrjetit të hapur, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve publikon standardet e ndërfaqeve teknike, të harmonizuara me standardet ndërkombëtare.

Sipas këtyre standardeve:

- a) kur një ofrues shërbimi zbaton këto standarde, ai përmbush kërkesat themelore;
- b) kur një operator telekomunikacionesh përmbush këto standarde, ai plotëson kërkesat për rrjet të hapur.

Neni 42

### **Detyrimet e organizmave me fuqi të ndjeshme në treg për interkoneksion**

1. Organizmat me fuqi të ndjeshme në treg duhet:

- a) t'u japin subjekteve, që kërkojnë interkoneksion, shërbime të njëjta, në kushte dhe në rrethana të njëjta;
- b) t'u japin operatorëve të tjerë pajisje dhe linja interkoneksioni së bashku me të dhënat përkatëse, me cilësi dhe tarifë të njëjtë me ato që ai ofron për shërbimet e veta dhe të filialeve, partnerëve ose ortakëve të tyre;

c) të sigurojnë, me përjashtim të rastit kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve parashikon ndryshe, të dhëna së bashku me specifikimet e nevojshme teknike për lidhjen e një marrëveshjeje interkoneksioni, si dhe të dhëna për zhvillimin e rrjetit në 6 muajt e ardhshëm;

ç) t'i paraqesin detyrimisht Entit Rregullator të Telekomunikacioneve kopje të marrëveshjeve të tyre me kërkesën e tyre të interkoneksionit dhe, me kërkesën e tyre, t'ua vënë në dispozicion të tretëve. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të vendosë që të dhëna të rëndësishme, me natyrë tregtare, të mos jepen, me përjashtim të të dhënave për tarifat dhe kushtet e interkoneksionit.

Për shkelje të paragrafit të parë të këtij neni, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund ta deklarojë marrëveshjen plotësisht ose pjesërisht të pavlefshme.

Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit të parë, shkronja "a" të këtij neni, kushtet dhe tarifat e vendosura për operatorët që zotërojnë rrjet mund të jenë të ndryshme nga ato për operatorët që nuk zotërojnë rrjet.

#### Neni 43

### **Marrëveshja e interkoneksionit**

Marrëveshja e interkoneksionit është marrëveshje ndërmjet dy palëve, që përcakton kushtet teknike dhe financiare të realizimit të interkoneksionit. Një kopje e marrëveshjes së interkoneksionit i paraqitet Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Me marrjen e kërkesës, çdo organizëm me fuqi të ndjeshme në treg duhet t'i japë kërkuarit një ofertë interkoneksioni.

Kur operatorët publikë të telekomunikacioneve nuk arrijnë të lidhin marrëveshje interkoneksioni brenda 2 muajve nga data e fillimit të bisedimeve, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, pasi shqyrton pretendimet e tyre, nxjerr urdhër me shkrim për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

#### Neni 44

### **Publikimi i kushteve të interkoneksionit**

Organizmi me fuqi të ndjeshme në treg duhet të publikojë kushtet teknike dhe tarifat e interkoneksionit.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, gjatë orarit të punës, duhet të vërë në dispozicion, pa pagesë, të palëve të treta të interesuara, marrëveshjet e interkoneksionit, me përjashtim të atyre pjesëve që kanë të bëjnë me strategjinë tregtare të palëve në marrëveshje. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton se cilat pjesë të marrëveshjes së interkoneksionit quhen strategji tregtare e palëve.

#### Neni 45

### **Marrëveshjet antikonkurrence**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ndërhyt që marrëveshjet për interkoneksionin të mos çënojnë parimet e konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve.

#### Neni 46

### **Tarifat për interkoneksion**

Tarifat e interkoneksionit duhet të jenë të orientuara drejt kostos së përdorimit të frytshëm të rrjetit.

Për përcaktimin e tarifave për interkoneksionin, nga organizmat me fuqi të ndjeshme në treg, do të zbatohen parime të njëjta me ato të përshkruara në nenet 60, 63, 64 dhe 65 të këtij ligji.

Neni 47  
**Detyrimi për licencë**

Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të ofrojë shërbime publike telekomunikacionesh brenda Shqipërisë ose ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi tjetër, pa qenë i pajisur me licencë të lëshuar sipas këtij ligji.

Neni 48  
**Klasifikimi i licencave**

Në sektorin e telekomunikacioneve, licencat klasifikohen:

a) Licenca individuale;

b) Licenca të përgjithshme.

- Licencat individuale klasifikohen në 2 klasa:

Klasa I. Licenca individuale e klasës I jepet për shërbimet publike telefonike, të palëvizshme dhe të lëvizshme, në shkallë kombëtare. Numri i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Klasa II. Licenca individuale e klasës II jepet për shërbime publike telefonike në zonat rurale, shërbime radioje të kërimit të personit, shërbime globale të komunikimeve vetjake të lëvizshme, dhe çdo shërbim tjetër, që përdor spektrin e radiofrekuencave.

- Licencat e përgjithshme jepen për ofrimin e aksesit në Internet, për shërbimet e transmetimit të të dhënave, për shërbimet me vlerë të shtuar, për shërbimet e telefonave publike me monedhë ose me kartë të parapaguar, si dhe për të gjitha shërbimet e tjera që nuk përmenden në klasën I dhe II të licencave individuale.

Këshilli i Ministrave bën klasifikimin e shërbimeve që mund të lindin në të ardhmen si rezultat i zhvillimit teknologjik.

Neni 49  
**Procedurat e licencimit**

Licencat individuale të klasit I u jepen subjekteve që fitojnë tenderin e hapur ndërkombëtar.

Me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Ministri i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave kriteret dhe kushtet e dhënies së licencave individuale të klasit I, si dhe procedurat e zhvillimit të tenderit.

Fillimi i procedurave të tenderit për dhënien e licencave individuale të klasit I bëhet me urdhër të Ministrit.

Licencat individuale të klasit II dhe licencat e përgjithshme jepen brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për licencë dhe kryerja e pagesave përkatëse.

Neni 50  
**Kriteret e marrjes së licencës**

Çdo person fizik ose juridik mund të kërkojë dhe të vlerësohet i aftë për licencë, nëse autoriteti licencues gjykon se ai zotëron besueshmëri, frytshmëri dhe njohuri të specializuara.

Cilido që garanton:

a) respektimin si i licencuar të dispozitave ligjore, vlerësohet se zotëron besueshmëri;

b) disponueshmërinë e mjeteve për ngritjen e rrjetit dhe veprimin e tij, të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencës, vlerësohet se ka frytshmëri;

c) njohuritë, përvojën dhe aftësitë e personave të angazhuar në ushtrimin e të drejtave të të licencuarit, vlerësohet se zotëron njohuri të specializuara.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të kërkojë të dhëna dhe dëshmi që mbështesin kërkesën dhe mund të kundërshtojë dhënien e licencës, nëse të dhënat e kërkuarit nuk përmbushin kriteret e këtij neni.

Këshilli i Ministrave miraton kriteret për marrjen e licencave individuale të klasit I.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve miraton kriteret për marrjen e licencave individuale të klasit II dhe të licencave të përgjithshme.

#### Neni 51

##### **Dhënia e licencave**

Licencat individuale të klasit I jepen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve pas daljes së urdhrit të Ministrit për shpalljen e fituesit.

Licencat individuale të klasit II dhe licencat e përgjithshme jepen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Licenca është e vlefshme për afatin e parashikuar në licencë dhe, ky afat, nuk mund të jetë mbi 25 vjet.

#### Neni 52

##### **Kushtet e licencës**

Licenca mund të përmbajë kushte për çështjet e mëposhtme:

1. Ofrimin e shërbimit në zonat rurale ose në ato me dendësi të rrallë popullimi ose në zona të tjera të veçanta.

2. Ofrimin e shërbimit për personat me aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçanta shoqërore.

3. Ofrimin e shërbimit të telefonise publike me monedhë ose kartë të parapaguar.

4. Zbatimin e kërkesave të veçanta për shërbime ndërkombëtare, siç janë detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i traktateve, vendosja e pagesave ndërmjet operatorëve në nivel ndërkombëtar dhe procedurat e shlyerjes së këtyre pagesave, kërkesat e vijimit të trafikut etj.

5. Detyrimin për pagimin e tarifës së licencës.

6. Pagimin, nga i licencuari, të kontributeve për mbajtjen e fondit të shërbimit të përgjithshëm ose të një fondi të ngjashëm me të;

7. Interkonektimin e sistemit të të licencuarit me sisteme të tjera, ndërfunksionimin e shërbimeve të sistemeve të ndryshme dhe zgjidhjen, nëpërmjet Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, të mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve për këto çështje.

8. Detyrimin e të licencuarit për t'u dhënë të dhëna Drejtorisë të Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, me qëllim që të verifikojnë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj ose respektimin e kushteve të licencës.

9. Publikimin e tarifave, të kushteve të shërbimit dhe mënyrën e këtij publikimi.

10. Respektimin e kërkesave teknike dhe të standardeve të cilësisë.

11. Dhënien e të dhënave për operatorët ose aksesit për një shërbim të tillë dhe zgjidhjen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve të mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve, për bashkëpunimin në dhënien e të dhënave për numëratoret.

12. Detyrimin për dhënien e një numri minimal linjash me qira.

13. Mbajtjen e një sistemi të caktuar kontabiliteti.

14. Ofrimin e shërbimeve për konsumatorët dhe, në veçanti, respektimin e kushteve dhe/ose normave të etikës profesionale për këto shërbime.

15. Detyrimin për rregullimin e tarifave, kur i licencuari është organizëm me fuqi të ndjeshme në treg.

16. Lidhjen e pajisjeve të përdoruesit me rrjetin e të licencuarit.

17. Detyrimin për respektimin e rregulloreve në zbatim të nenit 57.

18. Detyrimin për ofrimin falas të thirrjeve të urgjencës.

19. Dhënien e aksesit Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për të marrë automatikisht të dhëna për efekt kontrolli.

20. Kërkesën për t'u siguruar përdoruesve një njoftim të përshtatshëm për faturimin dhe tarifën.

21. Detyrimin për sigurimin kombëtar.

22. Detyrimin për mbajtjen e llogarive financiare të veçanta për biznesin ndërkombëtar.

23. Detyrimin për njoftimin për ndryshimin e strukturës së zotëruesve të aksioneve.



24. Detyrimin për të lidhur kontrata me përdoruesin për ofrimin e shërbimeve telefonike.
25. Detyrimin për ruajtjen për jo me pak se 2 vjet të faturave të përdoruesve të shërbimeve telefonike.

Neni 53

#### **Njoftimi i ankesave të licencuarit**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve njofton të licencuarin për çdo ankesë në adresë të tij, me qëllim që t'i japë atij mundësi të shpjegohet.

Neni 54

#### **Mospranimi**

- Kërkesa për licencë mund të mospranohet kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve:
- a) nuk ka në dispozicion frekuenca, të cilat mund t'i jepeshin kërkuarit që kërkon të përdorë pajisje radiokomunikacioni;
  - b) ka prova të mjaftueshme se:
    - (i) kërkuari i licencës nuk ka besueshmëri, frytshmëri dhe njohuri të specializura profesionale, që kërkojnë për ushtrimin e licencës;
    - (ii) si rezultat i dhënies së licencës, rrezikohet rendi publik ose sigurimi kombëtar.

Neni 55

#### **Ndryshimi dhe heqja e licencës**

- Licenca mund të ndryshohet, pezullohet ose hiqet në çdo kohë.
- Për të mbrojtur interesin publik dhe për të arritur objektivat e politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të ndryshojë kushtet e licencës pas kryerjes së një procesi këshillimi.
- Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të heqë licencën me nismën e vet ose në bazë të propozimit të inspektorëve të tij kur:
- a) pas dhënies së licencës vërtetohet se i licencuari, gjatë kërkesës për licencë, ka paraqitur të dhëna të rreme, të cilat vënë në dyshim zbatimin e kushteve të licencës;
  - b) i licencuari ka shkelur dispozitat e këtij ligji;
  - c) i licencuari nuk respekton kushtet e licencës;
  - ç) i licencuari ka falimentuar ose është shlyer;
  - d) i licencuari nuk ka bërë pagesën e licencës ose të tarifës së radiofrekuencave brenda 30 diteve nga afati i përcaktuar ose 15 ditë pas njoftimit të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Neni 56

#### **Transferimi i licencës**

- Ndalohet çdo marrëveshje për tjetërsimin, dhënien si mjet sigurimi, dhënien me qira ose këmbimin e licencës pa miratimin paraprak me shkrim të autoritetit licencues.
- Miratimi nuk duhet të vonohet pa arsye të fortë të motivuar.

Neni 57

#### **Udhëzimet dhe rregulloret**

- Për të plotësuar kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet e tjera nënligjore në fuqi, Ministri mund të nxjerrë udhëzime për:
- a) publikimin e marrëveshjeve të interkoneksionit;
  - b) zbatimin e procedurave për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e operatorit, si dhe mundësinë e portabilitetit të numrit;
  - c) përdorimin e përbashkët të pajisjeve dhe të aparaturave, duke përfshirë vendosjen e tyre në

mjedise të përbashkëta;

ç) respektimin e kërkesave themelore nga i licencuari, duke përfshirë sigurimin e funksionimit të rrjetit dhe ruajtjen e tërësisë së tij, ndërfunksionimin e shërbimeve, mbrojtjen e të dhënave, mbrojtjen e mjedisit, objektivat urbanistikë, në fshat dhe në qytet, përdorimin e spektrit të radiofrekuencave dhe shmangien e interferencave të dëmshme ndërmjet sistemeve të radiokomunikacioneve dhe sistemeve të tjera teknike, hapësirë ose tokësore;

d) numëracionin dhe zbatimin e një skeme numëracioni, të përcaktuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve;

dh) ndërfunksionimin e rrjeteve, për të siguruar cilësinë e shërbimit ndërmjet dy pikave fundore;

e) përgjimin e komunikimeve në rrjetin e të licencuarit;

ë) mbrojtjen e të dhënave të klienteve.

Në zbatim të këtij ligji, të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të udhëzimeve të nxjerra në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve nxjerr rregulloret e nevojshme, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar.

Rregulloret botohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

## KREU VI RREGULLIMI I TARIFAVE

### Neni 58

#### **Përcaktimi i tarifave**

Tarifat për shërbimet publike të telekomunikacioneve vendosen nga operatorët publikë të telekomunikacioneve dhe ofruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve.

### Neni 59

#### **Kontrolli i tarifave**

Tarifat e vendosura nga një organizëm me fuqi të ndjeshme në treg janë subjekt kontrolli. Mekanizmi dhe termat e kontrollit përcaktohen në licencë.

Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve çmon se në treg ka konkurrencë të frytshme për një shërbim ose grup shërbimesh, që është objekt i kontrollit të tarifave, në bazë të kushteve të licencës ai i propozon Ministrit për të paraqitur në Këshillin e Ministrave aktin nënligjor përkatës, që përjashton kontrollin e tarifave për një shërbim ose grup shërbimesh.

Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve çmon se konkurrenca për një shërbim ose grup shërbimesh në treg nuk është e mjaftueshme për të garantuar që tarifatat të jenë të arsyeshme, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve i propozon Ministrit për të paraqitur në Këshillin e Ministrave aktin nënligjor përkatës, që detyron zbatimin e kontrollit të tarifave mbi atë shërbim ose grup shërbimesh dhe cakton kushtet e kontrollit të tarifave.

Kur një licencë përmban kushte për kontrollin e tarifave, dispozitat e ligjit nr. 8044, datë 7.12.1995 "Për konkurrencën", zbatohen vetëm kur janë rrethanat e përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni.

### Neni 60

#### **Kriteret që zbatohen për rregullimin e tarifave**

Për organizmat me fuqi të ndjeshme në treg, tarifatat duhet të orientohen drejt kostos së ofrimit të shërbimit të frytshëm dhe njëkohësisht, të lejojnë që i licencuari të realizojë një fitim të arsyeshëm, të jenë transparente dhe të publikuara në mënyrë të përshtatshme, të mos përmbajnë zbritje të cilat shmangin mundësitë konkurruese të operatorëve të tjerë në tregun e telekomunikacioneve, si dhe të mos jenë diskriminuese e të garantojnë trajtim të barabartë.

Neni 61  
**Publikimi**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve publikon një herë në vit në Buletin e vet shërbimet dhe zonat përkatëse gjeografike, si dhe organizmat simotra me fuqi të ndjeshme në treg, ku ofruesit janë objekt i procedurave të rregullimit të tarifave.

Neni 62  
**Përcaktimi i metodologjisë për rregullimin e tarifave**

Me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Ministri i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave metodologjinë për rregullimin e tarifave.

Neni 63  
**Procedurat rregullatore për tarifat që janë objekt kontrolli**

Çdo vit kalendarik Enti Rregullator i Telekomunikacioneve verifikon përputhshmërinë e tarifave të zbatuara nga operatorët për shërbimet që i nënshtrohen kontrollit të tarifave me metodologjinë e miratuar dhe publikon rezultatet e verifikimit. Nëse vëren shmangie, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve merr masa dhe vendos afate për arritjen e përputhshmërisë së kërkuar.

Kur i licencuari kërkon të bëjë ndryshime tarifash, ai njofton, me shkrim Entin Rregullator të Telekomunikacioneve 60 dite para zbatimit të tarifave të reja.

I licencuari nuk duhet të ndryshojë tarifat për përdoruesit jashte metodologjisë dhe procedurave të miratuara.

Neni 64  
**Njoftimi i publikut**

Për çdo ndryshim të tarifave, i licencuari detyrohet të njoftojë përdoruesit me anë të mjeteve të informimit publik, të paktën 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave të reja dhe ky njoftim duhet të zgjasë jo me pak se 3 ditë rresht.

Neni 65  
**Ndalimi i zbatimit të tarifave shpërdoruese**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të ndalojë kryerjen e transaksioneve që përdorin tarifa, të cilat vijnë në kundërshtim me metodologjinë e rregullimit të tarifave.

**KREU VII**  
**NUMËRACIONI**

Neni 66  
**Hartimi dhe administrimi i planit të numëracionit**

Plani i numëracionit hartohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve është përgjegjës për strukturimin dhe konfigurimin e hapësirës së numëracionit për plotësimin në çdo kohë të kërkesave të operatorëve dhe të ofruesve të shërbimit. Elementet thelbësore të strukturimit dhe konfigurimit të planit të numëracionit duhet të botohen në Buletin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën administrimin e planit dhe caktimin e numrave për operatorët dhe ofruesit e shërbimit.

Caktimi i numrave nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të bëhet në kushte jodiskriminuese dhe të sigurojë një përdorim të frytshëm të tyre.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të vendosë kushte, të cilat duhet të plotësohen

nga kërkuesi i numrave. Këto kushte, si dhe rregullat për caktimin e numrave, botohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Neni 67

#### **Caktimi i numrave**

Numrat caktohen në bazë të kërkesës së operatorit dhe të ofruesit të shërbimit, kundrejt një pagese të caktuar.

Neni 68

#### **Ndryshimi i planit të numëracionit**

Për përmbushjen e detyrimeve ose të rekomandimeve ndërkombëtare dhe për të siguruar sasi të kënaqshme të numrave, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të ndryshojë strukturën dhe konfigurimin e hapësirës së numëracionit, si dhe caktimin e numrave. Ndryshimet e propozuara bëhen të njohura para miratimit të tyre.

Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve, që preken nga këto ndryshime, marrin të gjitha masat e duhura për zbatimin e tyre.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të marrë vendim për futjen e zgjedhjes dhe të parazgjedhjes së operatorit, për portabilitetin e numrit etj.

### **KREU VIII**

#### **RADIOKOMUNIKACIONET**

Neni 69

#### **Përdorimi i spektrit të radiofrekuencave**

Spektri i radiofrekuencave, si një burim natyror i kufizuar, përdoret për të përmbushur nevojat e përdoruesve. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të radiofrekuencave hartohet plani kombëtar i radiofrekuencave, si dhe mbikëqyrjen frekuencat e dhëna dhe përdorimi i tyre.

Neni 70

#### **Plani kombëtar i radiofrekuencave**

Plani kombëtar i radiofrekuencave ose ndryshimi i tij miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit. Hartimi i planit kombëtar të radiofrekuencave bashkërendohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve. Gjatë hartimit të këtij plani bashkëpunohet me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve dhe me institucionet shtetërore të ngarkuara për mbrojtjen kombëtare dhe për sigurimin e rendit publik, si dhe me KKRT-në.

Plani kombëtar i radiofrekuencave përmban shërbimet e radiokomunikacioneve për brezat përkatës. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të radiofrekuencave, plani kombëtar i radiofrekuencave përmban edhe dispozita që udhëzojnë përdorimin e radiofrekuencave, si dhe përcaktime të tjera me të hollësishme.

Neni 71

#### **Mbikëqyrja e spektrit të radiofrekuencave**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mbikëqyr të gjithë spektrin e radiofrekuencave, për të shmangur interferencat dhe për sigurimin e funksionimit normal të shërbimeve.

Neni 72

#### **Organet e administrimit të radiofrekuencave**

Spektri i radiofrekuencave administrohet nga:

a) Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për brezat e radiofrekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave të caktuara për transmetime radio e televizive, të cilat administrohen nga KKRT-ja;

b) Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për brezat e radiofrekuencave të caktuara për mbrojtjen kombëtare.

Për përdorimin e radiofrekuencave, përdoruesit civilë paguajnë një taksë, e cila përcaktohet me ligj të veçantë.

#### Neni 73

### **Bashkëpunimi ndërmjet organeve të administrimit të spektrit të radiofrekuencave**

Me qëllim që të mbrohen shërbimet e radiokomunikacioneve, organet e administrimit të spektrit të radiofrekuencave detyrohen të këmbëjnë të dhëna për caktimin e radiofrekuencave në brezat përkatës, si dhe të bashkëpunojnë për të identifikuar e zbuluar transmetimet dhe interferencat e paautorizuara.

#### Neni 74

### **Rregullimi dhe administrimi i radiofrekuencave**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve administron spektrin e radiofrekuencave për qëllime civile me përjashtim të spektrit të radiofrekuencave që përdoren për transmetime radio e televizive dhe kryen rregullimet që lidhen me veprimtarinë e spektrit të radiofrekuencave për qëllime civile, në përputhje me parashikimet në këtë ligj.

Rregullimet dhe veprimtaritë brenda sferës së radiokomunikacioneve duhet të përputhen me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet ku Republika e Shqipërisë është palë.

#### Neni 75

### **Dhënia dhe ndryshimi i radiofrekuencave**

Dhënia e radiofrekuencave bëhet në përputhje me planin kombëtar të radiofrekuencave dhe me rregulloret e telekomunikacioneve në fuqi.

Radiofrekuencat për pajisjet dhe stacionet e radiokomunikacionit jepen:

a) bashkë me licencën, kur kjo përmban radiofrekuencat përkatëse të punës;

b) me lejen e përdorimit të radiofrekuencave për raste të tjera.

Në bazë të kërkesës, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ofron informacion për mundësitë e caktimit të radiofrekuencave për shërbimet e radiokomunikacioneve.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ofron të dhëna për stacionet e rrjetet ekzistuese ose të planifikuara të radiokomunikacioneve në brezat e radiofrekuencave dhe në zonat gjeografike përkatëse, me përjashtim të atyre për transmetime radio e televizive.

#### Neni 76

### **Mospranimi i dhënies së radiofrekuencës**

Mospranimi i një procedure për dhënie radiofrekuence bëhet kur kushtet e përcaktuara për vendosjen e radiofrekuencës nuk zbatohen më ose kur ajo shihet e nevojshme nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Kur Enti Rregullator i Telekomunikacioneve e gjykon të arsyeshme, mund të bëhet ndryshimi i një radiofrekuence të dhënë.

Neni 77

### **Ndalimi i transferimit të radiofrekuencave të dhëna**

Radiofrekuencat për qëllime civile, me përjashtim të frekuencave për transmetime radiotelevizive, jepen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe nuk i transmetohen të tretëve.

Neni 78

### **Prodhimi dhe përdorimi i pajisjeve të radiokomunikacioneve**

Çdo person fizik ose juridik tregton, prodhon, vendos, zotëron ose përdor pajisje radiokomunikacioni, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 79

### **Përdorimi me licencë**

Çdo pajisje radiokomunikacioni, me përjashtim të pajisjeve radio e televizive, vendoset dhe përdoret vetëm kur është dhënë licenca nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për këtë qëllim ose në bazë të vendimeve të marra nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Pajisja e radiokomunikacionit, për të cilën është dhënë një licencë nga autoritetet e huaja, mund të sillët e përdoret në Shqipëri për një kohë të shkurtër, pa ndonjë autorizim tjetër, në rast se një gjë e tillë përcaktohet në rregulloret ndërkombëtare të njohura e të pranura nga Republika e Shqipërisë.

Neni 80

### **Kërkesa paraprake**

Pajisjet e radiokomunikacioneve duhet të përdorin vetëm radiofrekuencat e përcaktuara në licencë.

Kushdo që përdor pajisje radiokomunikacioni duhet të sigurojë që nuk do të ndodhë asnjë interferencë e papranueshme me shërbimet e tjera radio, përfshirë këtu edhe marrjen e transmetimeve radiotelevizive.

Çdo licencë lëshohet pasi të jetë bërë miratimi i tipit të pajisjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Në raste të veçanta, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mund të lejojë vendosjen dhe përdorimin e një pajisje të tillë edhe pa qënë tip i miratuar.

## **KREU IX**

### **MIRATIMI I TIPIT**

Neni 81

### **Rregulloret teknike**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve përcakton kërkesat teknike që duhet të plotësojnë pajisjet fundore të telekomunikacioneve.

Kërkesat duhet të synojnë sigurimin e jetës të përdoruesve dhe shmangien e interferencave me rrjetet dhe sistemet e tjera të telekomunikacioneve, si dhe përdorimin e frytshëm të spektrit të radiofrekuencave.

Neni 82

### **Procedurat e miratimit të tipit**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën miratimin e tipit të pajisjes në rast se pajisja përputhet me standardet e paraqitura nga neni 16 ose me standarde të njëjta me të shteteve të tjera, me

të cilat ka marrëveshje të njohjes ndërsjellë të miratimit të tipit.

Çdo subjekt, që prodhon, tregon ose importon pajisje fundore telekomunikacionesh në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të marrë miratimin e tipit. Për këtë Enti Rregullator i Telekomunikacioneve publikon listën e pajisjeve që kërkojnë miratim.

Neni 83

### **Miratimet e përkohshme**

Për pajisjet e telekomunikacioneve dhe radiokomunikacioneve me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën miratim të përkohshëm të tipit me procedura të thjeshtuara.

## **KREU X**

### **FUNKSIONIMI I ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Neni 84

### **Statusi dhe Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve**

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve është person juridik, publik, jobuxhetor. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të Rregullores së Brendshme, të miratuar nga ai vetë.

Selia e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve është në Tiranë.

Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë. Kuvendi cakton Kryetarin nga anëtarët e Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit është drejtuesi ekzekutiv i Entit Rregullator i Telekomunikacioneve.

Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë specialistë me arsim të lartë, të kualifikuar, të kenë të paktën 10 vjet përvojë pune dhe të përfaqësojnë sektorin e telekomunikacioneve, të ekonomisë, të drejtësisë dhe të administratës publike.

Çdo anëtar i Këshillit Drejtues përpara emërimit duhet të japë dorëheqjen nga çdo post ose funksion zyrtar, të terhiqet nga çdo veprimtari private fitimprurese, si dhe të shesë e të shlyejë çdo interes financiar që mund të ketë në shoqëri që ushtrojnë veprimtari tregtare nën juridiksionin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Nuk mund të zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues:

- a) personi, bashkëshorti ose të afërmit deri në shkallë të dytë, që kanë lidhje me anëtarët e Këshillit të Ministrave;
- b) personi që është dënuar nga gjykata për kryerjen e një veprë penale me vendim të formes së prerë;
- c) personi që është debitor ose kreditor në një shoqëri, e cila i nënshtrohet kuadrit rregullator të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve;
- ç) personi që përjashtohet me ligj për të mbajtur poste publike shtetërore.

Neni 85

### **Marrja e vendimeve dhe struktura e Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues merr vendimet me shumicë votash. Secili anëtar, duke përfshirë edhe Kryetarin, ka të drejtën e një vote. Asnjë vend bosh në Këshillin Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve nuk cënon të drejtën e anëtarëve që mbeten për të ushtruar të gjitha të drejtat e Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Në procesin e votimit nuk marrin pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, kur vërtetohet një nga rastet e parashikuara në nenin 37 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.

Pagat e anëtarëve të Këshillit Drejtues caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli Drejtues përcakton strukturën organizative, numrin dhe pagën e punonjësve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Këshilli Drejtues vendos rregullat dhe kriteret e punësimit sipas ligjeve në fuqi.

#### Neni 86

##### **Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues**

Anëtari i Këshillit Drejtues lirohet ose shkarkohet nga organi që e ka zgjedhur kur:

- a) është në pamundësi fizike ose mendore për të kryer funksionet e ngarkuara;
  - b) gjatë ushtrimit të detyrës është dënuar, nga gjykata, për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë;
  - c) emërohet punonjes në administratën shtetërore ose zgjidhet deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ose në organet e pushtetit vendor, me përjashtim të rastit kur është anëtar i shoqatave profesionale ose politike dhe mban funksione në to;
  - ç) pa shkak të arsyeshëm nuk ka pranuar të kryejë ose nuk kryen detyrën ose është i paaftë për të ushtruar detyrën për një periudhë 6- mujore ose me shumë;
  - d) përfshihet në ndonjerën nga dispozitat e nenit 84 të këtij ligji.
- Kur një anëtar lirohet ose shkarkohet nga detyra, sipas paragrafit të parë të këtij neni, anëtari i ri emërohet nga organi përkatës, sipas nenit 84 të këtij ligji.
- Çdo anëtar i liruar ose i shkarkuar nga detyra nuk ka të drejtë të rizgjidhet në Këshillin Drejtues.

#### Neni 87

##### **Financimi dhe buxheti i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve**

Burimet e financimit të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve janë tarifatat e caktuara për përpunimin e aplikimeve dhe të kërkesave të ndryshme, sipas këtij ligji, si dhe pagesat për licencat e dhëna nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Jo me vonë se tre muaj para fillimit të çdo viti financiar, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve cakton një fond të shpenzimeve operative të parashikuara dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

Të gjitha të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve kalojnë në buxhetin e shtetit.

#### Neni 88

##### **Raportimi**

Në përfundim të çdo viti, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve i paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit raport për punën e bërë dhe programin e vitit pasardhës.

Gjatë vitit Enti Rregullator i Telekomunikacioneve jep të gjitha të dhënat që Ministri i gjykon të nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve.

#### Neni 89

##### **Publikimi**

Dokumentacioni i skeduar i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve është i hapur për publikun gjatë një kohë të caktuar brenda orarit zyrtar. Këto skeda përfshijnë dokumentacionin që indeksohet sipas udhëzimeve, procedurave dhe standardeve që cakton Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, duke respektuar parimin e ruajtjes së sekretit.

Dokumentacioni i rëndësishëm si kriteret e licencimit, procedurat, licencat e dhëna, rregullat e rregulloret teknike, standardet etj., publikohen në Buletinin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.



## KREU XI PAGESAT

### Neni 90 **Llojet e pagesave**

Kryhet me pagesë pranë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve:

- a) përpunimi i kërkesave për licencim;
- b) dhënia e licencës;
- c) pagesë vjetore e licencës;
- ç) pajisja me numra;
- d) miratimi i tipit.

Pagesa për pikat “a”, “b”, “ç” dhe “d” bëhet vetëm njëherë, ndërsa pagesa për pikën “c” çdo vit.

### Neni 91 **Përcaktimi i pagesave për licencat**

Me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Ministri i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave masen e pagesave, të përcaktuara në nenin 90 të këtij ligji. Kriteri bazë në përcaktimin e nivelit të pagesave është mbulimi i kostos administrative të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

## KREU XII INSPEKTIMI, MBIKËQYRJA DHE MASA ADMINISTRATIVE

### Neni 92 **Inspektimi**

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit kryhet nga inspektorët e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

Inspektorët e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset ku i licencuari zhvillon veprimtarinë edhe pa e njoftuar paraprakisht, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të kushteve të parashikuara në licencën e dhënë.

I licencuari nuk ka të drejtë t'i ndalojë inspektorët për të kryer inspektimin dhe është i detyruar të bashkëpunojë me ta.

I licencuari është i detyruar t'u japë të dhëna inspektorëve, kur ata e kërkojnë një gjë të tillë.

Inspektori, kur nevojitet ekspertizë e veçantë, mund të marrë ekspertë.

### Neni 93 **Blokimi i pajisjeve**

Inspektorët bllokojnë dhe të mbyllin me vulosje pajisjet, kur për përdorimin e tyre nuk është marrë ndonjë licencë, kur ato nuk janë të miratuara ose kur nuk plotësohen kërkesat e licencës.

Pajisjet e bllokuara inventarizohen dhe sekuestrohen me kalimin e afatit 1-mujor nga data e bllokimit dhe më pas i jepen për shitje subjekteve të ngarkuara me ligj. Pjesa e të ardhurave nga shitja, që rregullohet me kontratën përkatëse ndërmjet Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe subjektit të mësipërm, kalon në buxhetin e shtetit.

### Neni 94 **Kundërvajtjet administrative**

Kur inspektorët e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve vërtetojnë se i licencuari ka

shkelur këtë ligj, kushtet e licencës dhe rregulloret e miratuara, kanë të drejtë:

a) të vendosin gjobë, në zbatim të nenit 96 të këtij ligji, dhe të kërkojnë nga i licencuari marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e saj;

b) t'i propozojnë Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ndalimin e veprimtarisë së të licencuarit;

c) t'i propozojnë Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve heqjen e licencës.

Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, pasi shqyrton propozimin e inspektorëve në përputhje me shkronjat "b" dhe "c" të këtij neni:

(i) paralajmëron të licencuarin, me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë;

(ii) ndalon ose heq licencën individuale ose licencën e përgjithshme.

Për t'i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin ose heqjen e licencës, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi.

Nëse edhe pas degjimit të të licencuarit, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve e miraton marrjen e vendimit, ai i jep të licencuarit një kopje. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve boton vendimin në Buletinin e vet dhe ndjek zbatimin e tij.

#### Neni 95

##### **Ankimi**

Për vendimet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve që ndalojnë, heqin ose ndryshojnë kushtet e licencës mund të bëhet ankesë pranë Ministrit, brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit. Ministri, brenda 30 ditëve nga data e ankimit, vendos për ankimin e bërë.

Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

#### Neni 96

##### **Gjobat**

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga të licencuarit, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë për rastet kur vërehen:

a) të dhëna të rreme ose mosdhënie të dhënash, të kërkuara nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve, sipas nenit 19 të këtij ligji;

b) vëniet në punë të një stacioni radiokomunikimi pa marrë licencë, sipas nenit 79;

c) tregtimi i pajisjeve të telekomunikacioneve pa marrë miratimin e tipit, sipas nenit 82.

2. Me gjobë nga 250 000 deri në 1 000 000 lekë për rastet kur:

a) palët e treta, me pakujdesi mund të dëmtojnë nyjet, linjat, stacionet transmetuese dhe ndonje pajisje tjetër telekomunikacionesh, në kundërshtim me nenin 14. Në këtë rast, keta të fundit detyrohen të zhdëmtojnë të gjitha shpenzimet që bëhen për të sjelle pajisjet në gjendjen e mëparshme;

b) nuk i jepet përparësi transmetimit të mesazheve, që kanë të bëjnë me përballimin e fatkeqësive natyrore dhe me sigurimin e mbrojtjes kombëtare dhe të rendit publik, sipas nenit 20 dhe nenit 26;

c) shkelet neni 24 ose neni 25;

ç) shkaktohet interferencave nga operimi i një stacioni radioje dhe/ose operimi i pajisjeve të radiokomunikimit në frekuenca të ndryshme nga ato të përcaktuara në licencë, sipas nenit 80;

d) ndalohet hyrja e inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet e telekomunikacioneve ose kur nuk jepet informacioni i nevojshëm, sipas nenit 90;

dh) dëmtohet shëndeti i përdoruesve dhe ndotet mjedisi, sipas nenit 32;

e) shkelet neni 34;

ë) investitorët ndërtues shkelin nenin 15.

3. Me gjobë nga 1 000 000 deri në 10 000 000 lekë për rastet kur:

a) operon në një rrjeti publik telekomunikacionesh ose ofron shërbime publike të telekomunikacioneve bëhet pa u pajisur me licencë, sipas nenit 47;

b) nuk sigurohet mbrojtja e sekretit të mesazheve ose komunikimi i përmbajtjes së tyre personave të paaautorizuar, sipas nenit 22;

c) kundërshtohet urdhri i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për interkoneksion, sipas nenit 43;

ç) ofrohen tarifa në kundërshtim me metodologjinë e tarifave, sipas nenit 63;

d) cenohet sekreti profesional, sipas nenit 23.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë inspektori përkatës bëhet ankim në Këshillin Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve brenda 10 ditëve nga data e dhënies së tij. Këshilli Drejtues i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve merr vendim brenda 30 ditëve nga data e dhënies së gjobës.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankimi, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr., datë “Për kundërvajtjet administrative” me ndryshimet e plotësimet e mëvonshme.

Gjoha është titull ekzekutiv që vilet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe derdhet në buxhetin e shtetit.

#### Neni 97

#### **Bashkëpunimi me organet e tjera**

Për ushtrimin e të drejtave, që burojnë nga ky ligj, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve duhet të mbështetet nga autoritetet publike vendore dhe ato policore.

#### KREU XIII

#### DISPOZITA KALIMTARE TË FUNDIT

#### Neni 98

#### **Vazhdimësia e funksionimit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve**

Këshilli Drejtues i Entit Rregullator i Telekomunikacioneve, i emëruar sipas ligjit nr. 8288, datë 18.2.1998, “Për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve”, vazhdon të funksionojë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Anëtarët e tij vazhdojnë të qendrojnë në detyrë brenda afatit të caktuar në mandatin e emërimit. Llogaritja e afatit të mandatit bëhet duke filluar nga data e emërimit të tyre.

Vendimet dhe urdhrat e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ose të Ministrit dhe të gjitha licencat e lëshuara, në mbështetje të ligjit nr. 8038, datë 23.11.1995, “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8287, datë 18.2.1998, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8038, datë 23.11.1995, “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” ose të ligjit nr. 8288, datë 18.2.1998, “Për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve”, mbeten në fuqi dhe veprojnë, pavarësisht nga shfuqizimi i këtyre ligjeve, deri në çastin e ndryshimit të tyre në përputhje me kërkesat e këtij ligji, por jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 99

#### **Shfuqizime**

Ligji nr. 8038, datë 23.11.1995, “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 8287, datë 18.2.1998, “Për disa ndryshime në ligjin nr.8038, datë 23.11.1995, “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”” dhe ligji nr. 8288, datë 18.2.1998, “Për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve”, shfuqizohen.

Pika 4, e nenit 3, të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, shfuqizohen.

Neni 100  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2668, datë 3.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**L I G J**  
**Nr. 8623, datë 15.6.2000**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË HUNGARISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, TRAFIKUT TË DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Hungarisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2666, datë 24.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**MARRËVESHJE**  
**MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, TRAFIKUT TË DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR.**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Hungarisë, të quajtura më poshtë “Palë”,

- duke kërkuar të japin kontributin e tyre në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe,
- të bindura për rëndësinë e bashkëpunimit në luftën dhe parandalimin efikas të krimit të organizuar, veçanërisht krimet e lidhura me drogën, terrorizmin dhe trafikun e njerëzve,
- të shqetësuara për rritjen e abuzimit dhe shpërndarjes së paligjshme të drogave dhe

- lëndëve psikotrope në botë;
  - duke dëshiruar të bashkërendojnë veprimet kundër krimit të organizuar ndërkombëtar për të kufizuar përdorimin e dokumenteve të fallsifikuara të udhëtimit dhe dokumenteve që synohen të përdoren për të kryer krime;
  - duke marrë parasysh traktatet ndërkombëtare në fuqi mbi këto fusha;
- Kanë rënë dakord si më poshtë :

#### Neni 1

(1) Palët duke u bazuar në kuadrin e tyre ligjor, bashkëpunojnë për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar .

(2) Palët do të bashkëpunojnë veçanërisht në raste të krimeve apo përgatitjeve për krim të kryera në territorin e njëres nga Palët dhe të shkëmbimit të të dhënave të kërkuara, që lidhen me territorin e Palës tjetër.

#### Neni 2

(1) Autoritetet kompetente të Palëve :

Përsa i takon Republikës së Shqipërisë :

- Ministria e Rendit Publik,
- Ministria e Punës dhe Përkrahjes Sociale,
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë,
- Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,
- Drejtoria e Policisë Kufitare,
- SHIK .

Përsa i takon Republikës së Hungarisë :

- Ministria e Brendshme,
- Ministria e Mirëqenies Sociale,
- Drejtoria Kombëtare e Policisë,
- Ministria e Financave dhe Drejtoria Kombëtare e Kufirit dhe Zyra e Sigurimit Kombëtar,
- Drejtoria Kombëtare e Doganave

brenda qëllimit të autoritetit dhe juridiksionit të tyre, do të bashkëpunojnë në zbatimin e drejtpërdrejtë, operativ dhe diplomatik të kësaj Marrëveshje .

(2) Organet e autorizuar të Palëve, sipas autoritetit dhe juridiksionit të tyre respektiv do të bashkëpunojnë në zbatimin e kësaj Marrëveshje në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe operative, ku sipas një plani bashkëpunimi të specifikojnë fushat e veçanta të bashkëpunimit dhe metodën e mbajtjes së kontaktit .

(3) Në mungesë të ndonjë marrëveshje tjetër, gjuha e komunikimit midis organeve bashkëpunuese do të jetë anglishtja .

#### Neni 3

Në përputhje me kuadrin respektiv ligjor dhe mbështetur në parashikimet e kësaj Marrëveshje, Palët për të luftuar terrorizmin do të :

(1) Shkëmbejnë përvojë profesionale dhe informacion mbi sulmet terroriste të kryera ose që parashikohen të kryen, ose personat që marrin pjesë në këto akte terroriste, mbi metodologjinë e zbatimit si dhe pajisjet teknike që do të përdoren gjatë këtij zbatimi.

(2) Shkëmbejnë përvojë profesionale dhe informacion mbi organizatat terroriste dhe anëtarët, planet dhe zbatimet e tyre për të shkaktuar dëm në territorin ose kundër intersave të Palës tjetër, për të luftuar terrorizmin ose të eliminonjë krime serioze të caktuara që çënojnë rendin publik

(3) Shkëmbejnë informacion mbi trafikun e paligjshëm të armëve , eksplozivëve dhe lëndëve radioaktive .

#### Neni 4

Në përputhje me kuadrin respektiv ligjor dhe për të parandaluar kultivimin, prodhimin, importin, eksportin dhe tranzitimin dhe për më tepër shpërndarjen e paligjshme të drogave, lëndëve psikotrope si dhe prekursorëve, Palët veçanërisht do të :

(1) njoftojnë njëra-tjetrën mbi të gjithë informacionin e rëndësishëm në lidhje me fshehjen që u bëhet këtyre lëndëve, mjetet e transportit, veprimet e personave të përfshirë në prodhimin dhe tregtimin e paligjshëm të drogave, vendet e origjinës dhe të mbërritjes të drogave, lëndëve psikotrope si dhe hollësirave të tjera të lidhura me këtë krim;

(2) shkëmbejnë informacion mbi metodat e zakonshme dhe karakteristikat e rëndësishme të trafikimit ndërkombëtar të drogës;

(3) shkëmbejnë konkluzione mbi kërkimet kriminalistike dhe kriminologjike në lidhje me trafikun dhe abuzimin e drogës;

(4) Të prodhojnë specimene të drogave dhe lëndëve psikotrope me origjinë biologjike ose etike të mundshme për t'u abuzuar në secilin vend ;

(5) Të shkëmbejnë përvoja në kontrollin e trafikut të paligjshëm të drogave, lëndëve psikotrope e prekursorëve duke patur parasysh mundësinë e abuzimit me to .

(6) Të zbatojnë masa të bashkërenduara policore të lejuara nga kuadri respektiv ligjor për të parandaluar prodhimin e paligjshëm të drogave dhe të lëndëve psikotrope ;

#### Neni 5

Palët do të bashkëpunojnë në hetimin dhe parandalimin e krimit të organizuar, gjatë kohës që do të :

(1) Njoftojnë njëra-tjetrën mbi informacione të rëndësishme lidhje me persona të përfshirë krimin e organizuar dhe lidhjet midis kriminelëve, strukturat midis tyre, strukturat e organizatave dhe grupeve të përfshira në veprimtari kriminale, sjellje tipike të grupeve të kriminelëve, faktet e gjetura, veçanërisht përsa i takon kohës, vendit dhe metodave të kryerjes krimeve, objektet e sulmuara, kushtet e veçanta, ligjet penale si dhe masat e marra;

(2) zbatojnë sipas kërkesës masa policore të lejuara sipas ligjit të vendit të Palës pritëse; në bazë të kësaj marrëveshje dhe kuadrit respektiv ligjor për hetime duke harmonizuar masat policore e të personelit, mbështetjen materialeve organizative;

(3) shkëmbejnë informacion dhe përvoja mbi metodat dhe format e reja të krimit ndërkombëtar.

(4) Shkëmbejnë të dhëna kriminalistike ose kriminalogjike dhe të dhëna të tjera që lidhen me krimet si dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi praktikat e hetimit, e metodologjive të tyre dhe pajisjet gjithmonë me mendimin për përmirësim;

(5) në bazë të kërkesës, shkëmbejnë eksperiencë dhe informacion mbi specimenet e provave materiale të mbledhura nga kryerja e krimeve ose të përdorura në krime;

(6) shkëmbejnë ekspertë për provovimin e luftës kundër krimit të organizuar, për trainimin e zgjerimin e trainimit në mënyrë që të rritet standarti i njohurive të veçanta të kërkuara mbi pajisjet moderne të kohës si dhe metodat e kërkuara dhe arritjet në teknologjinë e luftës kundër krimit;

(7) organizojnë sesione pune për lehtësimin e përgatitjeve dhe zbatimin e masave të koordinuara no nivelin e duhur.

#### Neni 6

Bashkëpunimi i Palëve do të mbulojë kryesisht:

1) shkëmbimin e informacionit në lidhje me kuadrin ligjor përsa i takon statusit dhe përmirësimit të rendit dhe sigurisë publike.

2) shkëmbimin e legjislacionit dhe përvojat përsa i takon të huajve dhe migracionit;

3) shkëmbimin e informacionit përsa i takon të ardhurave që nxirren nga krimi;

4) shkëmbejnë informacion mbi kontrabandën e mallrave;

5) shkëmbejnë informacion dhe përvojë kërkuar nga Pala tjetër, për të luftuar kundër trafikut të njerëzve si dhe për të parandaluar punësimin e paligjshëm.

## Neni 7

Sipas kuadrit ligjor kombëtar në fuqi të secilës Palë përsa i takon respektimit të ruajtjes të të dhënave personale, do të mbizotërojnë kushtet e mëposhtme:

1) Të dhënat personale mund t'i dërgohen vetëm autoriteteve kompetente të përfshira në luftën kundër terrorizmit, drogës, krimit të organizuar dhe figurave të tjera të krimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje. Dërgimi i të dhënave autoriteteve të tjera do të përbëjë objekt të një pëlqimi paraprak të Palës dërguese;

2) Sipas kërkesës së Palës dërguese, Pala marrëse do të japë të dhëna mbi përdorimin e të dhënave të marra dhe rezultateve të arritura me to;

3) pala dërguese do të shikojë korrektesën e të dhënave që do të dërgohen si dhe nevojën dhe përpjestimin e dërgimit të të dhënave të dërguara gjithmonë me sqarimin se cili është qëllimi i këtij dërgimi.

Për më tepër, nga pala tjetër do të kërkohen kushtet që kufizojnë dërgimin e të dhënave përcaktuar nga ligjet e brendshme. Nëse provohet se të dhënat e dërguara nuk janë të sakta apo nuk lejohej të dërgoheshin, duhet të njoftohet menjëherë Pala marrëse. Pala marrëse do të jetë e detyruar që të korrigjojë menjëherë ndonjë të dhënë të pasaktë ose të asgjësojë të dhënat që nuk lejohej të dërgoheshin, gjithnjë sipas konfirmimit të Palës dërguese.

4) Sipas kërkesës të dhënat do të merren nga persona të përshtatshëm për t'i mirëpërdorur ato dhe detyrimi për dërgimin e tyre bëhet vetëm sipas mandateve në bazë të ligjeve të vendit të veçantë. Informimi mbi të dhëna të veçanta do të bëhet sipas ligjeve të vendit që i dërgon këto të dhëna.

5) Pala dërguese, sipas dërgesës që bën, duhet të specifikojë afatet e zbatueshme për asgjësimin e të dhënave siç është përcaktuar në kuadrin e saj ligjor; çfarëdo lloj afatesh të caktohen, të gjitha të dhënat që dërgohen në lidhje me një person, duhet të eliminohen kur ato nuk nevojiten më. Pala dërguese duhet njoftuar pa vonesë për asgjësimin e të dhënave që do të marrë dhe arsyet për këtë gjë. Të gjitha të dhënat e marra do të asgjësohen me skadimin e kësaj Marrëveshje.

6) Të dyja Palët janë të detyruara të regjistrojnë dërgimin, marrjen dhe asgjësimin e informacioneve.

7) Palët janë të detyruara të mbrojnë me efikasitet të dhënat personale ndaj njohjes së paaautorizuar, ndryshimit apo bërjes së tyre publike.

#### Neni 8

1) Palët do të dërgojnë si “sekret” të gjitha të dhënat e klasifikuara nga njëra nga Palët, në rast se ato klasifikohen si të tilla sipas normave ligjore të vendit dërgues.

2) Transferimi i materialeve dhe të të dhënave të dërguara sipas kësaj Marrëveshje, një Palë të tretë, do të përbëjë objekt të miratimit të organeve kompetente të Palës dërguese.

#### Neni 9

1) Palët do të ngrenë një Komitet të Përbashkët me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organeve bashkëpunuese për të zbatuar këtë Marrëveshje; palët do të njoftojnë njëra-tjetrën përmes kanaleve diplomatike, mbi përbërjen e Komitetit të Përbashkët.

2) Komiteti i Përbashkët do të takohet të paktën dy herë në dy vjet. Secila nga Palët mund të kërkojë thirrjen e sesioneve të tjera nëse gjykohet si e nevojshme. Sesionet e Komitetit do të mbahen në mënyrë alternative në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Hungarisë.

3) Komiteti i Përbashkët do të ketë përgjegjësinë për lehtësimin e bashkëpunimit të parashikuar në këtë Marrëveshje dhe për kontrollin e efikasitetit të saj.

4) Shpenzimet për sesionet, përjashtuar shpenzimet e urdhërimit, do të mbulohen nga Pala pritëse.

#### Neni 10

1) Secila palë mund të refuzojë pjesërisht ose plotësisht plotësimin e kërkesës, masës bashkëpunuese ose ndihmës, ose mund t'i vërë disa kushte këtij plotësimi, nëse kërkesa mund t'i kufizojë të drejtat kombëtare, mund t'i rrezikojë sigurinë ose interesat të tjera thelbësore të saj, ose mund të shkelë kuadrin e saj ligjor kombëtar.

2) Parashikimet e kësaj Marrëveshje, nuk ndikojnë mbi traktate të tjera dypalëshe ose shumëpalëshe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, dhe nga Republika e Hungarisë.

#### Neni 11

Palët do të bien dakord për të emëruar reciprokisht një person të stafit diplomatik të ambasadave të tyre në vendin e palës tjetër, për të mbajtur kontakt me organin qendror kombëtar të palës marrëse.

#### Neni 12

1) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës kur Palët reciprokisht të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim përmes kanaleve diplomatike për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore që kërkojnë për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje.

2) Palët do të nënshkruajnë këtë Marrëveshje për një kohëzgjatje të përcaktuar kohe. Secila Palë mund të shfuqizojë këtë Marrëveshje duke dhënë njoftim me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Pala tjetër.

Hartuar në dy kopje në.....me..... në gjuhët shqip, hungareze dhe anglisht dhe që të tre tekstet janë të barazvlefshëm. Në rast mospërputhjes, do të merret parasysh teksti në anglisht.

NË EMËR TË QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

NË EMËR TË QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË



**L I G J**  
**Nr. 8624, datë 15.6.2000**

**PËR ADERIMIN NË “KONVENTËN E HAGËS” “PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE  
BASHKËPUNIMIN PËR BIRËSIMET JASHTË VENDIT”**

Në mbështetje të neneve 78,83 pika 1 dhe 21 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit””.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2667, datë 24.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**KONVENTA MBI MBROJTJEN E FËMIJËVE  
DHE BASHKËPUNIMIN PËR BIRËSIMET JASHTË VENDIT**

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente;

Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi,

Duke rikujtuar se çdo Shtet duhet të marrë me përparësi masat e duhura për të mundësuar që fëmija të mbetet në kujdesin e familjes së tij të origjinës,

Duke pranuar se birësimi jashtë vendit mund të ofrojë avantazhin e një familjeje të përhershme për një fëmijë, për të cilin nuk mund të gjëndet një familje e përshtatshme në Shtetin e tij të origjinës,

Duke qenë të bindur për nevojën e marrjes së masave për të siguruar që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore dhe që të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve,

Me dëshirën për të vendosur dispozitat të përgjithshme për këtë qëllim, duke patur parasysh parimet e shpallura në instrumentet ndërkombëtare, sidomos në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të 20 nëntorit 1989 dhe në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqënien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me Vendosjen në një Familje Ushqyese dhe Birësimin Brenda dhe Jashtë Vendit (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 41/85, e 3 dhjetorit 1986),

U morën vesh për dispozitat e mëposhtme:

## KAPITULLI I SFERA E KONVENTËS

### Neni 1

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

- a) të merren masat mbrojtëse për të siguruar që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore, të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare;
- b) të krijohet një sistem bashkëpunimi midis Shteteve Kontraktuese, për të siguruar që këto masa të respektohen dhe në këtë mënyrë të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve;
- c) të sigurohet njohja në Shtetet Kontraktuese e birësimeve të bëra në përputhje me këtë Konventë.

### Neni 2

1. Konventa zbatohet kur një fëmijë, i cili zakonisht banon në një Shtet Kontraktues (“Shteti i origjinës”), është shpërngulur, shpërngulet ose do të shpërngulet në një Shtet tjetër Kontraktues (“Shteti pritës”), ose pas birësimit të tij në Shtetin e origjinës, nga bashkëshortë ose nga një person që banon zakonisht në Shtetin pritës, ose për qëllime të një birësimi të tillë në Shtetin pritës ose në Shtetin e origjinës.
2. Konventa mbulon vetëm birësimet që krijojnë një marrëdhënie të përhershme prind-fëmijë.

### Neni 3

Konventa nuk zbatohet më, në rast se pëlqimet e përmendura në Nenin 17 nënparagrafi c, nuk janë dhënë para se fëmija të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

## KAPITULLI II KËRKESAT PËR BIRËSIME JASHTË VENDIT

### Neni 4

Një birësim brenda sferës së kësaj Konvente kryhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të Shtetit të origjinës:

- a) kanë përcaktuar se fëmija mund të birësohet;
- b) kanë vendosur, mbasi janë shqyrtuar si duhet mundësitë për vendosjen e fëmijës brenda Shtetit të origjinës, se birësimi jashtë vendit është në interesin më të lartë të fëmijës;
- c) kanë siguruar se
  - (1) personat, institucionet dhe autoritetet, pëlqimi i të cilëve për birësim është i domosdoshëm, janë këshilluar sipas nevojës dhe janë informuar siç duhet mbi pasojat e pëlqimit të tyre, pavarësisht nëse birësimi arrin ose jo në ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore midis fëmijës dhe familjes së tij të origjinës,
  - (2) të tillë persona, institucione dhe autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre në mënyrë të vullnetshme, në formën e kërkuar ligjore dhe e kanë shprehur ose evidentuar atë me shkrim,
  - (3) pëlqimet nuk janë dhënë me pagesë ose kompensim të çdo lloji dhe nuk janë tërhequr, dhe
  - (4) pëlqimi i nënës kur është kërkuar, është dhënë pas lindjes së fëmijës; dhe
- d) janë siguruar, në lidhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës se
  - 1) ai është këshilluar dhe informuar në mënyrën e duhur për pasojat e birësimit dhe të pëlqimit të dhënë prej tij për birësim, në rast se ky pëlqim kërkohet,
  - 2) janë pasur parasysh dëshirat dhe mendimet e fëmijës,
  - 3) pëlqimi i fëmijës për birësim, në rastet kur ky birësim kërkohet, është dhënë në mënyrë të vullnetshme, në formë ligjore të kërkuar dhe është shprehur ose evidentuar me shkrim, dhe
  - 4) një pëlqim i tillë nuk është bërë me pagesë apo kompensim të çdo lloji.

## Neni 5

Birësimi në kuadrin e Konventës do të bëhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të Shtetit pritës:

- a) kanë vendosur që prindërit e ardhshëm birësues kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar;
- b) janë siguruar se prindërit e ardhshëm birësues janë këshilluar sipas nevojës; dhe
- c) kanë vendosur që fëmija është autorizuar ose do të autorizohet për të hyrë dhe për të banuar përgjithmonë në atë Shtet.

## KAPITULLI III AUTORITETET QENDRORE DHE ORGANET E AKREDITUARA

## Neni 6

(1) Një Shtet Kontraktues do të caktojë një Autoritet Qendror për t'i kaluar këtij autoriteti detyrimet që ka në bazë të Konventës.

(2) Shtetet Federativë, shtetet me më shumë se një sistem legjislativ ose shtetet që kanë njësi territoriale autonome, janë të lira të caktojnë më shumë se një Autoritet Qendror dhe të përcaktojnë shtrirjen e funksioneve të tyre territoriale apo personale. Kur një Shtet ka caktuar më shumë se një Autoritet Qendror, ai cakton Autoritetin Qendror, të cilit mund t'i drejtohet njoftimi për transmetim Autoritetit Qendror përkatës brenda atij Shteti.

## Neni 7

(1) Autoritetet Qendrore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në Shtetet e tyre, për të mbrojtur fëmijët dhe për të arritur objektivat e tjera të Konventës.

(2) Ato marrin drejtpërdrejt të gjitha masat e duhura:

- (a) për të siguruar informacion lidhur me ligjet e Shteteve të tyre për birësimin dhe informacion tjetër të përgjithshëm, si statistika dhe formularë standard;
- (b) për të informuar njëri-tjetrin lidhur me funksionimin e Konventës dhe për të eliminuar sa më shumë çdo pengesë në zbatimin e saj.

## Neni 8

Autoritetet Qendrore marrin të gjitha masat e nevojshme, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet autoriteteve publike, për të parandaluar përfitime financiare ose përfitime të tjera të parregullta në lidhje me një birësim dhe për të mos lejuar asnjë praktikë që bie në kundërshtim me qëllimet e kësaj Konvente.

## Neni 9

Autoritetet Qendrore marrin të gjitha masat e nevojshme, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet organeve të tjera të akredituara rregullisht në Shtetin e tyre, sidomos:

- a) për të mbledhur, ruajtur dhe shkëmbyer informacion lidhur me gjendjen e fëmijës dhe prindërit e ardhshëm birësues, për aq sa është e nevojshme për realizimin e birësimit;
- b) për të lehtësuar, ndjekur dhe shpejtuar procedurat lidhur me sigurimin e birësimit ;
- c) për të nxitur dhe zhvilluar këshillimin lidhur me birësimin dhe shërbimet pas birësimit në Shtetet e tyre;
- d) për t'i dhënë njëri-tjetrit raporte vlerësimesh të përgjithshme mbi përvojën e birësimit në vende të tjera;
- e) për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoriteteve të tjera Qendrore ose autoriteteve të tjera

publike, aq sa e lejon ligji i Shtetit të tyre, për informacione mbi gjendjen e një birësimi të veçantë.

#### Neni 10

Akreditimi u bëhet dhe mbahet vetëm nga organet që tregojnë kompetencë për të realizuar si duhet detyrat që u ngarkohen.

#### Neni 11

##### **Një organ i akredituar**

a) ndjek vetëm objektiva jofitimprurëse, sipas kushteve dhe caqeve të përcaktuara nga autoritetet kompetente të Shtetit akreditues;

b) drejtohet dhe ka një personel me persona të kualifikuar në normat e sjelljes dhe që kanë kualifikim ose përvojë për të punuar në fushën e birësimit jashtë vendit; dhe

c) i nënshtrohet mbikqyrjes së autoriteteve kompetente të atij Shteti lidhur me përbërjen, funksionimin dhe gjendjen financiare.

#### Neni 12

Një organ i akredituar në një Shtet Kontraktues mund të veprojë në një Shtet tjetër Kontraktues vetëm në rast se autoritetet kompetente të të dy Shteteve kanë autorizuar një gjë të tillë.

#### Neni 13

Emërimi i autoriteteve Qendrore dhe, sipas rastit, shtrirja e funksioneve të tyre, si dhe emrat dhe adresat e organeve të akredituara do t'i komunikohen nga secili Shtet Kontraktues Zyrës së Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

### KAPITULLI IV

#### KËRKESAT PROCEDURIALE NË BIRËSIMIN JASHTË VENDIT

#### Neni 14

Personat që zakonisht banojnë në një Shtet Kontraktues dhe që dëshirojnë të birësojnë një fëmijë, zakonisht banues në një Shtet tjetër Kontraktues, i drejtohen Autoritetit Qendror të Shtetit ku banojnë zakonisht.

#### Neni 15

(1) Në rast se për Autoritetin Qendror të Shtetit pritës përmbushen kërkesat që aplikuesit kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar, ai përgatit një raport, i cili përfshin informacion mbi identitetin e tyre, të drejtën dhe përshtatshmërinë për të birësuar, mbi biografinë e tyre, mbi familjen dhe gjendjen shëndetësore, mjedisin shoqëror, arsyet për birësim, mundësinë për të ndërmarrë një birësim jashtë vendit, si dhe karakteristikat e fëmijëve, për të cilët ata do të zgjidhen të kujdesen.

(2) Ai transmeton raportin e Autoritetit Qendror Shtetit të origjinës.

#### Neni 16

(1) Në rast se Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës përmbushen kërkesat që fëmija është i birësueshëm, ai:

a) përgatit një raport, i cili përfshin informacion mbi identitetin e tyre, përshtatshmërinë për t'u birësuar, biografinë e tyre, mjedisin shoqëror, historinë e familjes, gjendjen shëndetësore, përfshirë atë të familjes së fëmijës dhe çdo nevojë të veçantë të fëmijës;

b) i kushton vëmendjen e duhur edukimit të fëmijës dhe formimit të tij etnik, fetar dhe

kulturore;

c) sigurohet që të jenë dhënë pëlqimet në përputhje me Nenin 4; dhe

d) përcakton, në bazë të raporteve të veçanta lidhur me fëmijën dhe prindërit e ardhshëm birësues, nëse vendosja është në interesat më të larta të fëmijës.

(2) Ai transmeton Autoritetin Qendror të Shtetit Pritës raportin e tij mbi fëmijën provën se janë marrë pëlqimet e nevojshme dhe arsyet e vendimit për vendosjen e fëmijës, duke treguar kujdes që të mos zbulojë identitetin e nënës dhe të babait, në rast se në shtetin e origjinës këto identitete nuk mund të deklarohen.

#### Neni 17

Çdo vendim në shtetin e origjinës se një fëmijë duhet t'u besohet prindërve të ardhshëm birësues, mund të merret vetëm në rast se:

a) Autoriteti Qendror i atij shteti ka dhënë sigurime se prindërit e ardhshëm birësues e pranojnë këtë;

b) Autoriteti Qendror i Shtetit pritës e ka miratuar një vendim të tillë, kur ky miratim kërkohet nga ligji i atij Shteti ose nga Autoriteti Qendror i shtetit të origjinës;

c) Autoritetet Qendrore të të dy shteteve janë marrë vesh që birësimi të kryhet dhe

d) në përputhje me Nenin 5 është vendosur që prindërit e ardhshëm birësues kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar dhe se fëmija është i autorizuar ose do të autorizohet për të hyrë dhe për të banuar përgjithmonë në Shtetin pritës.

#### Neni 18

Autoritetet Qendrore të të dy Shteteve ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar lejimin e fëmijës që të largohet nga Shteti i origjinës dhe të hyjë e të banojë përgjithmonë në Shtetin pritës.

#### Neni 19

(1) Transferimi i fëmijës në Shtetin pritës mund të kryhet në rast se janë përmbushur kërkesat e nenit 17.

(2) Autoritetet Qendrore të të dy Shteteve sigurohen që transferimi të bëhet në rrethana të sigurta dhe të përshtatshme dhe, në rast se është mundur, me shoqërimin e prindërve birësues ose të prindërve të ardhshëm birësues.

(3) Në rast se nuk bëhet transferimi i fëmijës, raportet e përmendura në Nenet 15 dhe 16 u kthehen mbrapsht autoriteteve që i kanë dërguar.

#### Neni 20

Autoritetet Qendrore informojnë njëri-tjetrin lidhur me procesin e birësimit dhe masat e marra për realizimin e tij, si dhe mbi progresin e vendosjes së fëmijës, në rast se kërkohet një periudhë prove.

#### Neni 21

(1) Kur birësimi do të bëhet pas transferimit të fëmijës në Shtetin pritës dhe kur Autoritetit Qendror të Shtetit i duket se qëndrimi i vazhdueshëm i fëmijës me prindërit e ardhshëm birësues nuk është në interesat më të larta të fëmijës, Autoriteti Qendror merr masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, në mënyrë të veçantë:

(a) për të tërhequr fëmijën nga prindërit e ardhshëm birësues dhe për të gjetur një përkujdesje të përkohshme;

(b) për të siguruar pa vonesë, në konsultim me Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës një kujdes alternativ për birësim ose, kur kjo nuk është e përshtatshme, një përkujdesje të përkohshme; birësimi nuk bëhet pa njoftuar më parë, në mënyrën e duhur, Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës lidhur me prindërit e ardhshëm birësues .

(c) për të rregulluar, si zgjidhje të fundit kthimin e fëmijës, në rast se këtë e kërkojnë interesat e tij .

(2) Duke pasur parasysh sidomos moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës, me të duhet këshilluar dhe kur është rasti, të merret pëlqimi i tij në lidhje me masat që do të merren në bazë të këtij Neni.

#### Neni 22

(1) Funksionet e Autoritetit Qendror në bazë të këtij Kapitulli mund të kryhen nga autoritetet publike ose nga organet publike e akredituara në bazë të Kapitullit III, në atë shkallë që e lejon legjislacioni i Shtetit të tij.

(2) Çdo Shtet Kontraktues mund t'i deklarojë organit ku është depozituar Konventa se funksionet e Autoritetit Qendror sipas neneve 15 deri 21, mund të kryhen në atë Shtet, në shkallën që lejon legjislacioni dhe duke iu nënshtruar mbikqytjes të autoriteteve kompetente të atij Shteti edhe nga organe ose persona, të cilët:

a) plotësojnë kërkesat e integritetit, kompetencat profesionale, përvojës dhe përgjegjshmërinë të atij Shteti, dhe

b) janë të kualifikuar për normat morale dhe për kualifikimit ose përvojën në punë në fushën e birësimit jashtë vendit .

(3) Një shtet Kontraktues, i cili bën deklaratën e përmendur në paragrafin 2 informon Zyrën e Përhershme të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mbi emrat dhe adresat e këtyre organeve dhe personave.

(4) Çdo shtet kontraktues mund t'i deklarojë organit ku është depozituar Konventa se birësimet e Fëmijëve që zakonisht banojnë në territorin e tij mund të bëhen vetëm në rast se funksionet e Autoriteteve Qendrore kryen në përputhje me paragrafin 1.

(5) Pavarësisht nga çdo deklaratë e bërë në bazë të paragrafit 2, raportet e dhëna për Nenet 15 dhe 16 përgatiten, në secilin rast, në përgjegjësinë e Autoritetit Qendror ose të autoriteteve apo organeve të tjera, në përputhje me paragrafin 1.

### KAPITULLI V NJOHJA DHE PASOJAT E BIRËSIMIT

#### Neni 23

(1) Një birësim i vërtetuar nga Autoriteti Kompetent i Shtetit të birësimit, se është bërë në përputhje me Konventën, njihet nga veprimi i ligjit në Shtetet e tjerë Kontraktues. Vërtetimi përcakton si dhe kur është arritur marrëveshja, sipas Nenet 17, nënparagrafi (c).

(2) Secili Shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, njofton organun ku depozitohet Konventa mbi identitetin dhe funksionet e autoritetit ose autoriteteve, të cilët janë kompetentë në atë Shtet për të dhënë vërtetimin. Ai njofton gjithashtu organin ku depozitohet Konventa për çdo ndryshim në emërimin e këtyre autoriteteve.

#### Neni 24

Njohja e një birësimi mund të refuzohet në një Shtet Kontraktues vetëm në rast se birësimi bie në kundërshtim të hapur me politikën e tij publike, duke pasur parasysh interesat më të larta të fëmijës.

#### Neni 25

Çdo Palë Kontraktuese mund t'i daklorojë organit ku depozitohet Konventa se ai nuk është i detyruar sipas kësaj Konvente të njohë birësimet e bëra në përputhje me një marrëveshje të arritur në zbatim të Nenet 39, paragrafi 2.

## Neni 26

- (1) Njohja e një birësimi përfshin njohjen e:
- a) marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë midis fëmijës dhe prindërve të tij birësues;
  - b) përgjegjësinë prindërore të prindërve birësues ndaj fëmijës;
  - c) ndërprerjen e marrëdhënieve të mëparshme midis fëmijës dhe nënës apo babait të tij, në rast se birësimi ka një pasojë të tillë në Shtetin Kontraktues, kur është bërë.
- (2) Në rastin e birësimit që ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë, fëmija gëzon në Shtetin pritës dhe në çdo Shtet tjetër Kontraktues ku birësimi njihet, të drejta të barabarta me ato që rrjedhin nga birësimet që kanë pasojë të tillë në secilin Shtet.
- (3) Paragrafet e mësipërm nuk paragjykojnë zbatimin e çdo dispozite, që është më e favorshme për fëmijën dhe që është në fuqi në Shtetin Kontraktues, i cili pranon birësimin.

## Neni 27

- (1) Kur birësimi i lejuar në Shtetin e origjinës nuk ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë, ai mund të kthehet në një birësim të efektshëm në Shtetin, i cili njeh birësimin në bazë të Konventës:
- a) në rast se ligji i Shtetit pritës lejon një gjë të tillë, dhe
  - b) në rast se pëlqimet e përmendura në nenin 4, paragrafet c dhe d, janë dhënë për qëllim të një birësimi të tillë.
- (2) Neni 23 zbatohet ndaj vendimit që ndryshon birësimin.

## KAPITULLI VI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

## Neni 28

Konventa nuk prek asnjë ligj të një Shteti të origjinës, i cili kërkon që birësimi i fëmijës, zakonisht banues brenda këtij Shteti, të bëhet në këtë Shtet ose që ndalon vendosjen ose transferimin e fëmijës në Shtetin pritës.

## Neni 29

Nuk ka asnjë kontakt midis prindërve të ardhshëm birësues dhe prindërve të fëmijës apo ndonjë personi tjetër që kujdeset për fëmijën, përderisa të mos jenë plotësuar kërkesat e nenit 4, nënparagrafet a) deri në c) dhe të Nenit 5, nënparagrafi a; me përjashtim të rastit kur birësimi bëhet brenda një familjeje ose kur kontakti bëhet në përputhje me kushtet e vendosura nga autoriteti kompetent i Shtetit të origjinës.

## Neni 30

- (1) Autoritetet Kompetente të një Shteti Kontraktues sigurojnë që të mos jepet informacioni i mbajtur prej tyre në lidhje me origjinën e fëmijës, veçanërisht informacioni në lidhje me identitetin e prindit ose prindërve të tij, si dhe mbi historikun shëndetësor.
- (2) Ata sigurojnë që fëmija apo përfaqësuesi i tij të kenë mundësi të njihen me këtë informacion, nën kujdesin e duhur, në rast se këtë e lejon ligji i atij Shteti.

## Neni 31

Pa paragjykuar Nenin 30, të dhënat personale të grumbulluara ose të transmetuara në bazë të kësaj Konvente, sidomos të dhënat e përmendura në Nenet 15 dhe 16 përdoren vetëm për qëllimet, për të cilat janë mbledhur ose transmetuar.

## Neni 32

(1) Asnjëri nuk duhet të nxjerrë përfitime të parregullta financiare ose përfitime të tjera nga një veprimtari që lidhet me birësimin jashtë vendit.

(2) Mund të bëhen ngarkim ose të paguhet vetëm shpenzimet e bëra, përfshirë honorare të arsyeshme profesionale, për personat që janë marrë në birësim.

(3) Drejtorët, administratorët dhe nënpunësit që janë marrë me birësimin nuk marrin shpërblim që është në mënyrë të paarsyeshme i lartë, në raport me shërbimet e kryera.

## Neni 33

Një autoritet kompetent, i cili konstaton se ndonjë dispozitë e Konventës nuk është respektuar apo se ka rrezik serioz që të mos respektohet, informon menjëherë Autoritetin Qendror të Shtetit. Autoriteti Qendror përgjigjet për të siguruar marrjen e masave të nevojshme.

## Neni 34

Në rast se Autoriteti Kompetent i Shtetit të cilit i drejtohet një dokument e kërkon këtë, atij duhet t'i jepet një përkthim i vërtetuar se është në përputhje me origjinalin. Në rast se nuk është vendosur ndryshe, shpenzimet e këtij përkthimi përballohen nga prindërit e ardhshëm birësues.

## Neni 35

Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të veprojnë me shpejtësi në procesin e birësimit.

## Neni 36

Në lidhje me një Shtet, i cili ka dy ose më shumë sisteme legjislacioni për birësimin, të zbatuara në njësi të ndryshme territoriale:

a) çdo referencë për banesën e zakonshme në këtë Shtet interpretohet si referencë për banesën e zakonshme në njësinë territoriale të atij Shteti;

b) çdo referencë ndaj legjislacionit të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj legjislacionit në fuqi në njësinë territoriale përkatëse;

c) çdo referencë ndaj autoriteteve kompetente ose ndaj autoriteteve publike të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj atyre që janë autorizuar për të vepruar në njësinë territoriale përkatëse;

d) çdo referencë ndaj organeve të akredituara të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj organeve të akredituara në njësinë territoriale përkatëse.

## Neni 37

Në lidhje me një Shtet, i cili për birësimin ka një ose më shumë sisteme legjislacioni të zbatueshme në kategori të ndryshme personash, çdo referencë ndaj legjislacionit të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj sistemit të legjislacionit të përcaktuar me ligj nga ai Shtet.

## Neni 38

Një Shtet, brenda të cilit njësi të ndryshme territoriale kanë rregullat e tyre ligjore për birësimin, është i detyruar të zbatojë Konventën, ndërsa një Shtet me sistem legjislacioni të unifikuar nuk është i detyruar ta bëjë këtë.

## Neni 39



(1) Konventa nuk prek asnjë instrument ndërkombëtar, në të cilët Shtetet Kontraktues janë Palë dhe që përmban dispozita për çështje që rregullohen nga kjo Konventë, përveç rasteve kur Shtetet Palë në këtë instrument kanë bërë një deklaratë të kundërt.

(2) Çdo Shtet Kontraktues mund të hyjë në marrëveshje me një ose më shumë Shtete të tjerë Kontraktues për të përmirësuar zbatimin e Konventës në marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta. Këto marrëveshje mund të prishen vetëm nga dispozitat e Neneve 14 deri 16 dhe 18 deri 21. Shtetet që kanë përfunduar një marrëveshje të tillë i transmetojnë një kopje organit ku depozitohet Konventa.

Neni 40

Nuk lejohen rezerva për Konventën.

Neni 41

Konventa zbatohet në çdo rast kur një kërkesë e bazuar në Nenin 14 është marrë mbasi Konventa ka hyrë në fuqi në Shtetin Pritës dhe në Shtetin e origjinës.

Neni 42

Sekretari i përgjithshëm i Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mbledh, në intervale të rregullta, një Komision të Posaçëm për të shqyrtuar funksionimin praktik të Konventës.

## KAPITULLI VII KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 43

(1) Konventa është e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private në kohën e Sesionit të saj të Shtatëmbëdhjetë dhe nga Shtetet e tjera pjesëmarrëse në këtë Sesion.

(2) Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet dhe instrumentat e ratifikimit dhe pranimi ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës, organi ku depozitohet Konventa.

Neni 44

(1) Çdo Shtet mund të aderojë në Konventë mbasi ajo të ketë hyrë në fuqi, në përputhje me Nenin 46 paragrafi 1.

(2) Instrumenti i aderimit depozitohet pranë të njëjtit organ.

(3) Ky aderim ka efekt vetëm për marrëdhëniet midis Shtetit aderues dhe atyre Shteteve Kontraktues, të cilët nuk kanë kundërshtim për aderimin e tij brenda gjashtë muajve pasi kanë marrë njoftimin e përmendur në paragrafin b) të Nenit 48. Ky kundërshtim mund të bëhet nga Shtetet edhe në kohën kur ata ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë Konventën mbas një aderimi. Çdo kundërshtim i njoftohet organit ku depozitohet Konventa.

Neni 45

(1) Në rast se një Shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme legjislacioni për çështje që trajton kjo Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit se kjo Konventë shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në njërin ose në më shumë prej tyre dhe kjo deklaratë mund të ndryshohet duke bërë në çdo kohë një deklaratë tjetër.

(2) Çdo deklaratë e tillë i njoftohet organit ku depozitohet Konventa dhe shpreh në mënyrë të

qartë njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.

(3) Në rast se një Shtet nuk bën deklarata në bazë të këtij Neni, Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij Shteti.

#### Neni 46

(1) Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar tre muaj nga depozitimi i instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit, që përmendet në Nenin 43.

(2) Pas kësaj Konventa hyn në fuqi:

a) për secilin Shtet që rrjedhimisht ratifikon, pranon ose miraton atë, në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar tre muaj nga depozitimi i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

b) për një njësi territoriale, në të cilën është shtrirë Konventa, në përputhje me Nenin 45, në ditën e parë të muajit që vjen mbas mbarimit të tre muajve pas njoftimit që përmendet në këtë nen.

#### Neni 47

(1) Një Shtet Palë në këtë Konventë mund ta denoncojë atë me anën e një njoftimi me shkrim, drejtuar organit ku depozitohet Konventa.

(2) Denoncimi ka efekt në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit nga organi ku depozitohet Konventa. Kur në njoftim përcaktohet një periudhë më e gjatë për hyrjen në fuqi të denoncimit, denoncimi hyn në fuqi pas mbarimit të një periudhe të tillë më të gjatë, mbasi njoftimi të jetë marrë nga organi ku depozitohet Konventa.

#### Neni 48

Organi ku depozitohet Konventa njofton Shtetet Anëtarë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, Shtetet e tjera pjesëmarrëse në Sesionin e Shtatëmbëdhjetë dhe Shtetet që kanë aderuar, në përputhje me Nenin 44, përsa më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e përmendura në Nenin 43;

b) aderimet dhe kundërshtimet ndaj aderimeve, që përmenden në Nenin 44;

c) datën kur Konventa hyn në fuqi, sipas Nenit 46;

d) deklaratat dhe emërimet e përmendura në Nenin 22, 23, 25 dhe 45;

e) marrëveshjet e përmendura në Nenin 39;

f) denoncimet e përmendura në Nenin 47.

Për vërtetim, të nënshkruarit, të autorizuar ligjërisht, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 29 maj 1993, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, duke pasur të dy tekstet vlerë të barabartë, në një kopje të vemte, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Mbretërisë së Hollandës dhe një kopje e vërtetuar e së cilës i dërgohet, nëpërmjet kanaleve diplomatike, secilit Shtet Anëtar të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private në datën e Sesionit të saj të Shtatëmbëdhjetë dhe çdo Shteti tjetër që ka marrë pjesë në këtë Sesion.

### L I G J

**Nr.8625, datë 15.6.2000**

## **PËR CAKTIMIN E “DITËS SË TRIUMFIT TË PAQES”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

### **K U V E N D I**

#### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

Neni 1

Data 12 qershor shpallet “Dita e Triumfit të Paqes”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2669, datë 3.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

### **V E N D I M Nr.313, datë 13.6.2000**

#### **PËR FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PATENTAVE DHE MARKAVE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 118 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr.8477, datë 22.4.1999, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7819, datë 27.4.1994, “Për pronësinë industriale”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

#### **V E N D O S I:**

1. Fillimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Patentave dhe Markave si institucion qendror publik, në varësi të Këshillit të Ministrave.

2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nga buxheti i miratuar për vitin 2000, i zbriten 2 (dy) milionë lekë, dhe i vihen në dispozicion të Drejtorisë së Patentave dhe Markave, nga të cilat 1 255 000 lekë të detajuara për paga dhe sigurime shoqërore, dhe 745000 lekë për shpenzime operative. Efektet e tjera financiare, që mund të lindin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e krijuara nga vetë Drejtoria e Patentave dhe Markave.

3. Ngarkohet Drejtoria e Patentave dhe Markave, që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të hartojnë udhëzimin e përbashkët për përdorimin e të ardhurave.

4. Inventari fizik, që zotëron Drejtoria e Patentave dhe Markave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, i kalon Drejtorisë së Patentave dhe Markave, pranë Këshillit të Ministrave.

5. Selia e Drejtorisë së Patentave dhe Markave të jetë në mjediset që i takojnë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, sipas shkresës nr.2141/1, datë 21.10.1997.

6. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Patentave dhe Markave përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, mbi bazën e propozimit të bërë nga kjo drejtori.

7. Drejtoria e Patentave dhe Markave ngarkohet të nxjerrë rregulloren e saj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**V E N D I M**  
**Nr.315, datë 23.6.2000**

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË  
ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil” me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**I. KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS  
PUBLIKE**

1. Krijimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike, (më poshtë, instituti), institucion në varësi të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave ngarkon Departamentin e Administratës Publike, për menaxhimin e tij, sipas dispozitave të këtij vendimi.

Qendra e institutit është në Tiranë.

2. Instituti siguron formimin profesional të nëpunësve civilë.

Formimi profesional përfshin:

a) Trajnimin në periudhën e provës;  
b) Trajnimin për zhvillimin e karrierës;  
c) Trajnimin për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës, sipas nenit 24, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”;

ç) Trajnimin me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta;

d) Trajnimin për zhvillimin e njohurive profesionale;

3. Organet e institutit janë:

a) Drejtori i institutit

b) Bordi këshillimor

4. Departamenti i Administratës Publike ka këto detyra:

a) përcakton çdo vit programin e trajnimit të institutit;

b) merr vendime për gjithë veprimtarinë e institutit;

c) miraton kriteret, që duhet të plotësojnë trajnuesit e përhershëm;

ç) miraton rregulloren e brendshme të institutit.

5. Bordi këshillimor është organi këshillimor i institutit dhe përbëhet nga sekretarët e përgjithshëm të gjithë ministrive, dy përfaqësues të Qendrës së Trajnimit të Administratës Vendore dhe dy përfaqësues të Universitetit të Tiranës, të caktuar nga rektorati i tij, me kërkesën e drejtorit të Departamentit të Administratës Publike.

6. Drejtori i institutit emërohet sipas procedurave të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”. Drejtori i institutit duhet të përmbushë kërkesat ligjore për të qënë nëpunës civil dhe:

a) Të jetë mbi 30 vjeç.

b) të ketë mbaruar një shkallë të lartë dhe është e preferueshme të ketë një gradë shkencore në administratën apo menaxhimin publik.

c) Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga administrata publike, për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore dhe të mos jetë larguar nga shërbimi civil për paaftësi në kryerjen e detyrave.

7. Drejtori i institutit ka këto detyra:

- a) të përfaqësojë institutin në marrëdhëniet me të tretët;
  - b) të hartojë rregulloren e brendshme të institutit dhe ta paraqesë atë për miratim në Departamentin e Administratës Publike;
  - c) të zbatojë vendimet e Departamentit të Administratës Publike;
  - ç) të lidhë marrëveshje me institutet homologe dhe dhurues të ndryshëm, me miratimin e Departamentit të Administratës Publike;
  - d) të raportojë në Departamentin e Administratës Publike dhe Këshillin e Ministrave, për veprimtarinë e institutit;
  - dh) të lidhë kontratat me trainuesit e përhershëm, me miratimin e Departamentit të Administratës Publike;
  - e) të lidhë kontrata pune me specialistë vendas ose të huaj;
  - ë) të caktojë dhe të lidhë kontrata pune me nëpunësit e sekretarisë;
  - f) të drejtojë stafin e trajnuesve të përhershëm dhe të bashkërendojë punën ndërmjet tyre;
  - g) të përgatisë dhe të ndjekë zbatimin e programin e trajnimit në çdo fushë, pas miratimit nga Departamenti i Administratës Publike;
  - gj) të përgatisë projektbuxhetin e institutit;
  - h) të lëshojë çertifikatat, të cilat vërtetojnë kryerjen me sukses të trajnimit për çdo nëpunës, në mbështetje të vlerësimit të bërë nga trajnuesit e përhershëm.
8. Stafi i trajnuesve të përhershëm përbëhet nga katër persona, të cilët kanë këto detyra:
- a) të sigurojnë mbështetjen administrative për organizimin e trajnimeve;
  - b) të sigurojnë që referuesit e ftuar janë të kualifikuar;
  - c) të sigurojnë respektimin e programit të trajnimit të institutit,
  - ç) të bëjnë vlerësimin e rezultateve të trajnimit, për çdo nëpunës dhe në rastet e vlerësimit pozitiv, t'i propozojnë drejtorit të institutit, lëshimin e çertifikatës përkatëse;
  - d) të paraqesin propozimet e tyre për programin e trajnimit, te drejtori i institutit.
9. Referuesit. Drejtori i institutit në përputhje me programin e trajnimit fton për të referuar.
- a) pedagogë universitarë në fushën e administratës publike dhe menaxhimit publik;
  - b) praktikantë të shquar nga administrata publike;
  - c) këshillues të sektorit privat;
  - ç) specialistë vendas dhe të huaj.
10. Sekretaria. Pranë institutit funksionon një sekretari, e përbërë prej tre personash, e cila kryen detyra të karakterit ndihmës dhe teknik.
11. Të ardhurat dhe pasuria e institutit përbëhen nga:
- a) financimi nga buxheti i Këshillit të Ministrave
  - b) dhurimet dhe të ardhurat, që sigurohen nga dhurues të ndryshëm, vendas dhe të huaj, të interesuar për zhvillimin e administratës publike dhe, që nuk çenojnë qëllimin dhe funksionimin e institutit.
  - c) të ardhurat, që jepen nga ministritë e ndryshme për nevojat e nëpunësve të tyre, për trajnime të veçanta.

## II. TRAJNIMI NË INSTITUTIN E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

### TRAJNIMI I DETYRUESHËM

12. Nëpunësi civil i nënshtrohet veprimtarive të detyrueshme, të përgjithshme dhe të veçanta të trajnimit, në rastet si vijon:

- a) gjatë periudhës së provës, e përcaktuar në nenin 14 të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”.
- b) gjatë periudhës së përshtatjes profesionale, e përcaktuar në nenin 24, pika 1, e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”.
- c) me urdhër të drejtpërdrejtë të eprorit dhe me miratimin e Departamentit të Administratës Publike.
- ç) me urdhër të drejtpërdrejtë të eprorëve dhe me miratimin e departamenteve, drejtorive, seksioneve apo zyrave të personelit për institucionet e pavarura.

13. Trajnimi i parashikuar në shkronjën “a” të pikës së mësipërme, përfshin veprimtaritë e trajnimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për pozicionin e specialistëve në periudhë prove dhe

veprimtaritë e trajnimit të posaçëm (për vendin e punës) për pozicionet e tjera të nëpunësit civil.

Trajnimi i parashikuar në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës së mësipërme është trajnim i posaçëm.

14. Në rastet e parashikuara në pikën e mësipërme, drejtori i institutit, me kërkesën e Departamentit të Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore ose me kërkesën e departamenteve të personelit, krijon kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së trajnimit, sipas llojit të trajnimit, të përcaktuar në kërkesë.

### III. TRAJNIMI FAKULTATIV

15. Për rritjen e aftësive profesionale dhe për zhvillimin e karrierës, nëpunësi civil, pasi ka marrë miratimin e drejtpërdrejtë të eprorit, mund të paraqesë kërkesën e tij për trajnim të veçantë në sekretarinë e institutit. Drejtori i institutit, duke marrë në konsideratë mundësitë e institutit shqyrton, zgjidh kërkesën dhe jep përgjigje brenda 30 ditëve nga depozitimi i saj.

### IV. TRAJNIMI JASHTË VENDIT

16. Nëpunësi civil, mund të trajnohet jashtë vendit, në kuadrin e programeve të trajnimit, të organizuara nga institucioni, në përputhje me programet e përgjithshme të trajnimit, të hartuara nga Departamenti i Administratës Publike. Në mbarim të këtyre trajnimeve, punonjësi duhet të kthehet dhe të punojë në vendin e tij të mëparshëm, por jo më pak se dy vjet.

Kur nëpunësi refuzon të kthehet në vendin e mëparshëm, ai duhet të dëmshpërblejë institucionin për shpenzimet e kualifikimit.

17. Nëpunësi civil, mund të kryejë trajnime jashtë vendit, me iniciativën e tij, por për detyrën që ai kryen, për jo më shumë se 6 muaj, me propozimin e përbashkët të eprorit, të drejtorit të personelit të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit.

Nëpunësi civil, mund të kryejë trajnime mbi 6 muaj jashtë apo brenda vendit, të ndërmarra me iniciativën e vet, por për detyrën që ai kryen. Gjatë kësaj kohe ai pezullohet nga shërbimi civil.

### V. PAGESA GJATË PERIUDHËS SË TRAJNIMIT

18. Trajnimi i detyrueshëm dhe ai fakultativ në Institutin e Trajnimit të Administratës Publike kryhet pa shkëputje nga puna. Gjatë kohës së trajnimit nëpunësi merr pagën e plotë.

19. Trajnimi jashtë vendit, i organizuar nga institucioni është me shkëputje nga puna. Gjatë periudhës së trajnimit deri në 6 muaj, nëpunësi merr pagën bazë. Për periudhën e trajnimit që kalon 6 muaj, nëpunësit i ndërpritet paga dhe familjes së tij i jepet një shpërblim, i përcaktuar si më poshtë:

a) për nëpunësit pa ose me një pjestar në ngarkim, 40 për qind e pagës bazë;

b) për nëpunësit me shumë pjestarë në ngarkim, 50 për qind e pagës bazë;

20. Për periudhën e trajnimit deri në 6 muaj, të ndërmarra me iniciativën e vet nëpunësit, sipas paragrafit të parë të pikës 17, të këtij vendimi, nëpunësi paguhet me 30 për qind e pagës bazë, pavarësisht nga numri i anëtarëve të familjes në ngarkim.

Për trajnimet mbi 6 muaj, të ndërmarra me iniciativën e vet nëpunësit, ai nuk paguhet.

21. Dispozitat e këtij vendimi aplikohen edhe për funksionarët politikë.

22. Instituti i Trajnimit të Administratës Publike siguron trajnim edhe për nëpunësit e tjerë të administratës publike, sipas mundësive të tij dhe kërkesave të institucioneve përkatëse.

### VI. DISPOZITA E FUNDIT

23. Vendimi nr.101, datë 4.2.1998, i Këshillit të Ministrave, “Për disa masa tranzitore për formimin profesional të nëpunësve”, vendimi nr.189, datë 20.3.1998 i Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.101, datë 4.2.1998, “Për disa masa tranzitore për formimin profesional të nëpunësve””, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.319, datë 23.6.2000**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.433, DATË 3.9.1993, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR NDALIMIN E IMPORTIMIT TË GOMAVE TË PËRDORURA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Vendimi nr.433, datë 3.9.1993, i Këshillit të Ministrave, “Për ndalimin e importimit të gomave të përdorura”, me ndryshimet e bëra, shfuqizohet.
  2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të përgatisë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.325, datë 23.6.2000**

**PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE “PËR MIRËRRITJEN, ZHVILLIMIN DHE**  
**REHABILITIMIN E FËMIJËVE”, SI NJËSI BUXHETORE, E VEÇANTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 13, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shkëputjen e Qendrës Kombëtare “Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve”, nga Drejtoria e Shëndetit Publik, Tiranë, qytet dhe përcaktimin e saj si njësi buxhetore kombëtare të veçantë, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.
  2. Drejtorisë së Shëndetit Publik, Tiranë, qytet, i pakësohen në numrin e punonjësve 67 punonjës, të cilët i shtohen Qendrës Kombëtare “Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve”.
  3. Efektet financiare, që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Shëndetësisë.
  4. Ngarkohen Ministria e Financave, që, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të ndjekë procedurat e nevojshme për kalimin e fondeve buxhetore dhe për krijimin e strukturës së re buxhetore për këtë qendër.
  5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.329, datë 23.6.2000**

**PËR FINANCIMIN, NË VITIN 2000, TË PROGRAMEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT  
DHE TË ZHVILLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit për vitin 2000”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Fondi prej 50 milionë lekësh, i miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2000 për programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit, të shpërndahet sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Programi                                        | Milionë<br>lekë | Ministria/institucioni<br>Përgjegjës           |
|-----|-------------------------------------------------|-----------------|------------------------------------------------|
| 1.  | Albanologjia                                    | 7.5             | Akademia e Shkencave                           |
| 2.  | Sistemet dhe teknologjitë e informacionit       | 11.5            | Ministria e Arsimit dhe Shkencës               |
| 3.  | Bujqësia dhe ushqimi                            | 8.5             | Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit             |
| 4.  | Gjeologjia, nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve | 6.0             | Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit |
| 5.  | Pasuri natyrore                                 | 6.0             | Akademia e Shkencave                           |
| 6.  | Bioteknologjitë dhe diversiteti biologjik       | 10.5            | Ministria e Arsimit dhe Shkencës               |
|     | Shuma                                           | 50              |                                                |

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,    | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci,      | Anëtar i““““                   |
| Hajredin Fuga,  | Anëtar i““““                   |
| Alfred Karamuço | Anëtar i““““                   |
| Kristofor Peçi, | Anëtar i““““                   |
| Kujtim Puto,    | Anëtar i““““                   |
| Sokol Sadushi,  | Anëtar i““““                   |
| Sabri Rrapi,    | Anëtar i““““                   |

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 29.03.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.22 Akti, që i përket:



**KËRKUES:** ASTRIT ORUÇI, përfaqësuar nga avokat Artan Hajdari

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
2. MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL, përfaqësuar nga zotërinjtë Blendi Vathi dhe Shahin Bistri.

**O B J E K T I:**

Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 1 të Vendimit nr.46, datë 17.02.2000 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarëve të Komunave Ksamil, Helmas dhe Kurjan”.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave është i pambështetur në prova, pasi “organi i qeverisjes vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, vetëm për shkelje të rënda të Kushtetutës dhe të ligjeve”. Në veprimtarinë e tij si kryetar komune ka zbatuar me korrektësi Kushtetutën dhe ligjet;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk përmend asnjë fakt që të vërtetojë se ku konsistojnë shkeljet e rënda të kushtetutës ose të ligjeve nga ana e kërkuetit;

- Me organet e pushtetit dhe me prefekturën ka bërë debate për ndërtimet pa leje dhe për shitjet e paligjshme të trojeve nga ana e këshillit të rrethit;

- Për zhvillimin dhe shpalljen e tenderave që ngarkohet, nuk duhet të përgjigjet deri në shkarkimin e tij nga detyra, sepse nuk janë shkelje të karakterit të rëndë. Ka qenë komisioni ai që ka bërë procedurat e prokurimeve. Ai nuk mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për to;

- Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.390, datë 06.08.1993 “Për ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e vulave zyrtare”, nuk mund të përgjigjet, pasi atë e ka ruajtur me fanatizëm dhe nuk e ka shpërdoruar, në asnjë rast të vetëm.

**GJYKATA KUSHTETUESE**

pasi dëgjoi kërkuetin dhe avokatin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N**

Astrit Oruçi, kryetar i Komunës Ksamil të rrethit Sarandë, është shkarkuar nga detyra me vendimin nr.46, datë 17.02.2000, të Këshillit të Ministrave me këtë motivacion: “Për shkelje të rëndë të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 “Për organizmin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik” dhe të Vendimit nr.390, datë 06.08.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”.

Ky Vendim i Këshillit të Ministrave, është mbështetur në relacionin e ministrit të Pushtetit Lokal, ku janë paraqitur si shkelje të rënda: Nuk ka zbatuar mjaft vendime të këshillit të komunës, nuk ka raportuar para tij për probleme të ndryshme, nuk ka përgatitur e paraqitur buxhetin e komunës për vitin 1999; nuk ka dërguar për konfirmim në prefekturë pjesën dërrmuese të akteve të nxjerra nga këshilli dhe vetë ai, duke shkelur ligjin nr.7608, datë 22.09.1992 “Për prefekturat”; nuk ka zbatuar Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për rregullat e administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Departamenti Rajonal i Kontrollit të Lartë të Shtetit i datës 28.02.1999 si dhe për shkeljen e ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik”; për rilevimin e qendrës së Ksamilit, për ndërtimin e murit rrethues të varrezave të fshatit Ksamil si dhe për blerjen e një autoveture.

Kërkuesi Astrit Oruçi si në kërkesën që ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese edhe në shpjegimet e tij në seancën gjyqësore, nuk pranon të ketë bërë shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve, siç parashikohet në nenin 115/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai pranon se në veprimtarinë e administratës të komunës ka pasur shkelje të ndryshme, por pasi janë ballafaquar në

Ksamil e në këshillin e rrethit Sarandë me drejtues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, me prefektin në muajt qershor e korrik 1999 si dhe më pas në Ministrinë e Pushtetit Lokal, gjendja ishte përmirësuar. Kërkuesi parashtrroi se ka pasur debate për punën midis këshillit të komunës dhe atij, por këto debate kishin të bënin me funksionimin dhe zbatimin sa më të mirë të detyrave që ligji u ngarkon këtyre organeve. Po kështu debate e konflikte janë zgjidhur edhe me ndihmën e takimeve të lartpërmendura në muajt qershor-korrik e më pas.

Nga zhvillimi i gjykimit të çështjes, rezultoi se, pas ballafaqimeve të lartpërmendura, këshilli i komunës në përgjithësi ka funksionuar normalisht. Vendimet e marra nga ai këshill, janë zbatuar nga kryetari dhe administrata e komunës dhe se për shkeljen që i ngarkohet kërkuesit në relacionin e Ministrit të Pushtetit Lokal, dërguar Këshillit të Ministrave, ai paraqiti gjatë gjykimit dokumenta shkresore. Për shkeljen tjetër, se kërkuesi nuk ka raportuar përpara këshillit për probleme të ndryshme një herë në 6 muaj, rezultoi se në këshillin e komunës janë analizuar probleme të ndryshme si ekonomike, financiare, komunale, arsimore etj., ku kanë raportuar kryetari dhe funksionarë të tjerë të administratës së komunës sipas sektorëve që mbulojnë. Pra, nuk u vërtetua se kërkuesi për këtë pikë të relacionit të ketë shkelur rëndë nenin 34 të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

Shkelja e pretenduar nga subjekti i interesuar, se kërkuesi nuk ka përgatitur dhe paraqitur planin financiar për komunën Ksamil për vitin 1999, nuk mund të pranohet, sepse sipas nenit 21/2 të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992, ndryshuar me ligjin nr.8068, ddtë 15.02.1996, kryetari i komunës ia ka dërguar prefektit, çka rezultoi gjatë gjykimit të çështjes.

Përsa i përket pikës tjetër të relacionit, se kërkuesi nuk ka dërguar për konfirmim në prefekturën pjesën dërrmuese të akteve të nxjerra nga këshilli dhe vetë ai, të cilat përmenden si shkelje në ngarkim të tij, vihet në dukje se janë dërguar një pjesë e tyre. Nga ana tjetër, kjo detyrë, sipas nenit 40 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, i takon ta kryejë sekretari i komunës, për rrjedhojë nuk mund t’i ngarkohet kërkuesit.

Lidhur me zbatimin e detyrave të lëna nga Departamenti Rajonal i Kontrollit të Lartë të Shtetit i datës 28.02.1999, rezultoi se në përgjithësi janë vënë në zbatim, por ato detyra nuk i përkasin vetëm kryetarit, por edhe administratës së komunës sipas sektorëve përkatës. Në këto rrethana, nuk mund të konsiderohen shkelje e rëndë në kuptim të nenit 115/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me shkeljen e rëndë të ligjit nr.7971, datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik”, për rilevimin e sipërfaqes të 65 ha të qendrës së Ksamilit, për ndërtimin e murit rrethues të varrezave të fshatit Ksamil dhe për blerjen e një autoveture, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuesi, si kryetar i komunës, nuk mund të përgjigjet për shkelje të rëndë të ligjit të lartpërmendur. Sipas këtij ligji, kërkuesi është kryetar i entit prokurues dhe është komisioni i ngarkuar prej tij ai që shqyrton procedurat e nevojshme për ofertat e paraqitura, për fondet e prokurara dhe që janë vënë në dispozicion të komunës. Pra, shkeljet e evidentuara nga kontrollet e prefekturës dhe të Departamentit të Kontrollit Rajonal të Lartë të Shtetit për tenderat, janë të karakterit teknik dhe nuk është përgjegjësia e drejtpërdrejtë e kërkuesit, por e komisionit përkatës.

Edhe përsa i përket pikës tjetër të relacionit, që bën fjalë se kërkuesi ka shkelur vendimin nr.390, datë 16.08.1992 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, konkludohet se nuk konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit në kuptim të nenit 115/1 të Kushtetutës, fakti që kërkuesi e ka mbajtur vetë në ruajtje vulën e komunës. Rezultoi e provuar se ka qenë i detyruar nga situata në atë komunë ta mbante vetë vulën. Ambientet e zyrave kanë qenë të pasigurta deri në fillim të vitit 1999. Madje, u vërtetua se është vjedhur një zyrë e komunës. Nuk u provua gjatë gjykimit që kërkuesi ta ketë keqpërdorur vulën. Me krijimin e ambienteve të reja e të sigurta, ajo iu dorëzua sekretares të administratës me procesverbal të rregullt dhe me porosinë për ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e vulës, siç e kërkon vendimi i lartpërmendur i Këshillit të Ministrave.

Gjykata Kushtetuese, duke u mbështetur në dokumentacionin dhe provat që ndodhen në dosje si dhe faktin se subjekti i interesuar nuk vërteton të kundërtën e pretendimeve të kërkuesit, arrin në konkluzionin se kërkuesi nuk ka shkelur nenin 115/1 të Kushtetutës, për rrjedhojë Vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kryetarit të komunës Ksamil nga detyra duhet të shfuqizohet.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri.

## V E N D O S I:

Shfuqizimin e pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.46, datë 7.02.2000.  
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 23.05.2000  
Nr.22 i Regj. Themeltar  
Nr.32 i Vendimit

## V E N D I M

### “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |
|------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci,       | Anëtar i““““                   |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i““““                   |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i““““                   |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i““““                   |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i““““                   |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i““““                   |
| Sabri Rrapi,     | Anëtar i““““                   |

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 18.04.2000 dhe 04.05.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** AGIM EGRO, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku.

## O B J E K T I

Shfuqizim si antikushtetues i Vendimit nr.282, datë 23.06.1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Kërkuuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë:

Çështja penale në ngarkim të tij është shqyrtuar në kolegjin penal të Gjykatës së Lartë në mungesë dhe pa iu komunikuar rekursi i prokurorit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ndonëse gjatë gjithë kohës, nga data 30.06.1998, ka jetuar në banesën e tij në Yzberisht, kohë kur Gjykata e Apelit urdhëroi lirimin e tij nga burgu, pasi e dënoi me 4 vjet burg me kusht për 5 vjet kohë.

Nuk i është komunikuar as dita e gjykimit. Nuk është respektuar neni 435/2 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk i është caktuar mbrojtës kryesisht, për të cilin duhet të njoftohej.

Po kështu, Vendimi i Gjykatës së Lartë, vjen në kundërshtim edhe me nenin 437/4 të Kodit të Procedurës Penale, ku veç të tjerash parashikohet edhe rregullsia e lajmërimeve të palëve në proces.

Në këto rrethana, i është mohuar e drejta e mbrojtjes, pasi është gjykuar e dënuar në mungesë, duke u zhvilluar një proces i parregullt ligjor.

## GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi shpjegimet e avokatit të kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N

Kërkuar Agim Egro me Vendimin nr.48, datë 05.02.1998 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale të vrasjes me dashje në dëm të viktimës Lulëzim Egro dhe për armëmbajtje luftarake pa leje duke e dënuar përfundimisht për të dy veprat penale me 14 vjet burgim.

Mbi ankimin e të gjykuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.277, datë 10.06.1998, ka vendosur ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale nga vrasje me dashje në vrasje nga pakujdesia dhe në bazë të nenit 85 të Kodit Penal e ka dënuar me 4 vjet burgim. Ka lënë në fuqi atë vendim për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, që e kishte dënuar me 2 vjet burgim. Pasi ka bërë bashkimin e dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, përfundimisht e ka dënuar me 4 vjet burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal ka pezulluar vuajtjen e mëtejshme të dënimit, me kusht për 5 vjet kohë, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të pandehurit.

Mbi rekursin e ushtruar nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, kolegji penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.282, datë 23.06.1998, ka ndryshuar vendimin e kësaj të fundit, duke e deklaruar fajtor të gjykuarin për vrasje me dashje dhe në bazë të nenit 76 në lidhje me nenin 53 të Kodit Penal, e ka dënuar me 7 vjet burgim. Ka lënë në fuqi vendimin në lidhje me veprën penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Në zbatim të nenit 55/3 të Kodit Penal përfundimisht e ka dënuar me 7 vjet burgim.

Nga gjykimi i kësaj çështje në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese, rezultoi se nuk vërtetohet që t'i jetë komunikuar kërkuarit rekursi i prokurorit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë, e ka gjykuar dhe e ka deklaruar fajtor të pandehurin në mungesë dhe pa pjesëmarrjen e mbrojtësit. Në këtë rast ajo gjykatë ka shkelur neni 31/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke i mohuar të drejtën e mbrojtjes kërkuarit, pra është bërë një proces i parregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42/1.

Gjykata Kushtetuese, veç konstatimit se në aktet e dosjes nuk është kopja e komunikimit të rekursit kërkuarit, në bazë të nenit 41 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", pyeti me cilësinë e dëshmitarëve Kryesekretaren e gjykatës së rrethit Tiranë Flutura Kadiu, sekretaren e po kësaj gjykate Veronika Vata, e cila merret me komunikimin e akteve të asaj gjykate si dhe Drita Qerimin, që punon në Kryesekretarinë e Gjykatës së Lartë.

Këto dëshmitare, deklaruan se sipas rregullave ekzistuese, në sekretarinë përkatëse, dosja nuk dorëzohet në Gjykatën e Lartë pa u shoqëruar me dëftesën që vërteton komunikimin e rekursit. Por, për rastin konkret, nga shpjegimet e tyre nuk u provua që të jetë bërë ky komunikim në format e parashikuara në nenet 132 e 140 të Kodit të Procedurës Penale.

Rezultoi gjithashtu se në gjykimin e çështjes në kolegjin penal nuk janë mbajtur parasysh kërkesat e pikave 3 e 4 të nenit 437 të Kodit të Procedurës Penale, për verifikimin e legjitimitetit të palëve dhe të rregullsisë së lajmërimeve.

Në rrethanat e lartpërmendura, konkludohet se kolegji penal nuk ka patur parasysh edhe pikën 1 të nenit 33 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohej. Ky parim i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Është e qartë se shkeljet e lartpërmendura të lejuara nga kolegji penal i Gjykatës së Lartë, cënojnë parimin e mbrojtjes në gjyq dhe influencojnë drejtpërsëdrejti negativisht në dhënien e drejtësisë.

Pra, në këtë çështje del se është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, për rrjedhojë vendimi i atakuar i kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

Sipas nenit 77 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike që nga çasti i marrjes së tyre. Në këto rrethana, duhet të urdhërohet lirimi i të gjykuarit nga burg. Për realizimin e këtij detyrimi ligjor, në bazë të pikës 3 të nenit 81 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, ngarkohet Prokurori i Përgjithshëm, i cili do të veprojë në

bazë të neneve 67, 68 dhe 69 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ku parashikohet se lirimi i të dënuarve bëhet në bazë të ligjit, në rastin konkret me urdhër të prokurorit.

Gjykata Kushtetuese, çmon se ky vendim ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, prandaj, në bazë të nenit 26/1 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, do të hyjë në fuqi me shpalljen e tij.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të neneve 26,72,77,81 dhe 86 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, me shumicë votash,

## V E N D O S I:

1. Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.282, datë 23.06.1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin për rishqyrtim po në atë kolegji.

2. Të ngarkojë Prokurorin e Përgjithshëm për të kryer veprimet përkatëse, për lirimin e kërkuarit, Agim Egro.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me shpalljen e tij.

Tiranë, më 24.05.2000

Nr.25 i Regj. Themeltar

Nr.33 i Vendimit

## MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër mendimit të shumicës për arsyet që parashtroj më poshtë:

Në Gjykatën Kushtetuese çështja nuk ka ardhur të shqyrtohet në themel si çështje penale, por si një proces gjyqësor (ligjor) ndaj të cilit kërkuar ka kërkuar ushtrimin e kontrollit kushtetues. Është kjo arsyeja themelore nga nisem për të konkluduar se në këtë proces, barra e provës i përkiste kërkuarit. Në këtë aspekt, ishte ai që duhet të sillte provat e nevojshme e të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e tij kryesor, atë të mosnjohjes me rekursin e ushtruar nga prokurori i Apelit.

Nga sa parashtroi kërkuar, nga këqyrja e dosjes gjyqësore përkatëse si dhe nga shpjegimet e personave të pyetur në seancë, nuk mund të konkludohet në mënyrë kategorike se rekursi nuk është komunikuar. Është e vërtetë (përsa pretendohet nga kërkuar), se në dosje nuk gjendet akti i komunikimit të rekursit, por është po aq e vërtetë se (qoftë edhe me sy të lirë) konstatohet që nga dosja është hequr një dokument, i cili nuk mund të mos ishte akti që vërteton komunikimin e rekursit. Edhe mënyra e heqjes (çngjitja) nuk flet në favor të tezës së ngritur nga kërkuar.

Janë këto, disa nga argumentet që vërtetojnë se në këtë çështje pretendimet e kërkuarit mbeten të paprovuara plotësisht, sepse provat kontestojnë njëra-tjetrën dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për një qëndrim kategorik por kërkesës, ashtu siç ka vendosur shumica.

Tiranë, më 24.05.2000

ANËTARI  
**A. Karamuço**

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,    | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci,      | Anëtar i““““                   |
| Hajredin Fuga,  | Anëtar i““““                   |
| Kristofor Peçi, | Anëtar i““““                   |
| Sokol Sadushi,  | Anëtar i““““                   |
| Kujtim Puto,    | Anëtar i““““                   |

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 06.06.2000. mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.38 Akti, që u përket:

**KËRKUES:** NJË GRUP PREJ 36 DEPUTETËSH TË KUVENDIT, përfaqësuar nga deputeti Sokol Harizi.

**O B J E K T I**

Interpretimi i neneve 69 pikat, 1/d e 2; 70/2 dhe 179, pika 1 e 4 të Kushtetutës.

Në bazë të nenit 134 të Kushtetutës, një grup prej 36 deputetësh që përbën më shumë se 1/5 e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit, i kanë kërkuar Gjykatës Kushtetuese interpretimin e Kushtetutës për të drejtën e kryetarëve të bashkive dhe të komunave për të kandiduar e për t’u zgjedhur deputetë si dhe për të drejtën e deputetëve për të kandiduar e për t’u zgjedhur si kryetarë komune e bashkie. Ata kërkojnë gjithashtu interpretimin e Kushtetutës për të drejtën e këtyre të zgjedhurve për të mbajtur njëkohësisht dy mandate; atë të deputetit dhe atë të kryetarit të bashkisë ose komunës.

**GJYKATA KUSHTETUESE**

pasi dëgjoi përfaqësuesin e palës kërkuese dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndalon në mënyrë të shprehur qartë jo vetëm kandidimin, por edhe zgjedhjen si deputetë të kryetarëve të Komunave apo të Bashkive, duke e konsideruar si të pavlefshëm çdo mandat deputeti të fituar nga këta të fundit. Ky ndalim është përcaktuar në nenin 69/1 të Kushtetutës.

Kushtetuta nuk jep përgjigje të drejtpërdrejtë nëse deputeti ka të drejtë të kandidojë e të zgjidhet edhe kryetar bashkie apo komune. Por, ndërkohë ajo pranon direkt apo indirekt në nenet 69,70/2 e 71/2 se dy mandatet, pra ai i deputetit dhe ai i kryetarit të bashkisë së komunës, janë të papajtuashëm me njëri-tjetrin, sepse jo vetëm i ndalon kandidimin për deputet kryetarëve të bashkive e komunave, jo vetëm ndalon deputetët të ushtrojnë njëkohësisht detyrë tjetër shtetëtare (veç anëtar i Këshillit të Ministrave), por e konsideron të pavlefshëm mandatin e një deputeti kur është fituar pa hequr dorë nga detyra si kryetar bashkie apo komune.

Vetë delegimi i ushtrimit të pushtetit shtetëror nga populli tek deputetët, u jep mundësi këtyre të fundit të ushtrojnë veprimtari jo vetëm në hartimin e miratimin e ligjeve, por edhe në kontrollin e zbatimit të tyre. Për më tepër, në ligjin nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, e sidomos në nenet 6, 8 e 10 ku përcaktohen marrëdhëniet e tij me organet e pushtetit vendor, deputetit i janë dhënë kompetenca që në thelb janë kompetenca kontrolli, siç janë e drejta për të kërkuar shpjegime nga ato organe, e drejta të propozojë rishikimin ose shfuqizimin e aktit të marrë nga organet e pushtetit vendor etj. Këto kompetenca nuk mund të kryhen nëse deputeti zbaton njëkohësisht edhe kompetenca

ekzekutive në organin e pushtetit vendor.

Është e vërtetë që ligji nr.7491, datë 29.04.1994 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, nuk shprehej fare nëse deputeti ose këshilltari, mund të mbante ose jo dy mandate njëkohësisht dhe me ligjin nr.8143, datë 11.09.1996 “Për një ndryshim në ligjin nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 01.02.1996”, u lejua që deputeti mund të jetë në të njëjtën kohë edhe i zgjedhur në organet e pushtetit vendor, por kjo nuk do të thotë se neni 179 i Kushtetutës në fuqi duhet të interpretohet që të zgjedhurit kanë të drejtë të mbajnë njëkohësisht të dy mandatet deri në mbarim të afatit të këtyre mandateve. Neni 179 zgjidh problemin e jetëgjatësisë së disa organeve, ndërmjet të tjerave edhe të organeve të qeverisjes vendore, por kjo nuk pengon që për persona të veçantë, mandati të mbarojë para afatit si psh, në rastet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës, ku përfshihet edhe vërtetimi i kushteve të pazgjidhshmërisë ose të papajtueshmërisë të mandatit të deputetit.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon, se deputeti nuk ka të drejtë të kandidojë e të zgjidhet kryetar komune e bashkie pa hequr dorë nga ajo detyrë dhe asnjë prej këtyre, nuk mund të mbajë njëkohësisht dy mandate e të ushtrojë dy funksione, atë të deputetit dhe atë të organit ekzekutiv në pushtetin vendor. Këtij qëndrimi i përmbahet edhe Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr.8609, datë 08.05.2000. Ata që i kanë fituar të dy mandatet sipas ligjeve të mëparshme dhe që i mbajnë njëkohësisht të dy mandatet kanë të drejtë të zgjedhin nëse do të heqin dorë nga mandati i deputetit apo nga ai i kryetarit të bashkisë e komunës.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 134/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 72 e 79 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### V E N D O S I:

Sipas neneve 69/1 pika “d”, 69/2, 70/2 dhe 71/2 pika “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kryetarët e bashkive dhe komunave nuk kanë të drejtë të kandidojnë e të zgjidhen deputetë dhe anasjelltas, deputetët nuk kanë të drejtë të kandidojnë e të zgjidhen kryetarë bashkie e komune, pa hequr dorë nga kjo detyrë.

Funksioni i deputetit, është i papajtueshëm me atë të kryetarit të bashkisë apo komunës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

Tiranë, më 23.06.2000  
Nr.38 i Regj.Themeltar  
Nr.37 i Vendimit

#### V E N D I M

#### “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |
|------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Sabri Rrapi,     | Anëtar i““““                   |
| Zija Vuci,       | Anëtar i “““                   |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i“““                    |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i “““                   |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i “““                   |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i “““                   |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i “““                   |

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 10.05.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar nga Spartak Braho.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.
2. Këshilli i Ministrave, në mungesë.

**O B J E K T I**

Interpretimi i nenit 103/3 të Kushtetutës së Shqipërisë

Një grup prej 36 deputetësh të kuvendit të shqipërisë, me cilësinë e subjektit që vë në lëvizje një gjykim kushtetues, të cilët përbëjnë jo më pak se një të pestën e deputetëve, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të interpretuar nenin 103/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, lidhur me pozitën juridike që duhet të kenë anëtarët e Këshillit të Ministrave të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit, përse i përket imunitetit si dhe përcaktimit të organit që jep autorizimin për fillimin e çështjes penale ndaj tyre.

**GJYKATA KUSHTETUESE**

pasi dëgjo i përfaqësuesin e kërkesve dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N**

Neni 103/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit. Kjo dispozitë e Kushtetutës i jep anëtarëve të Këshillit të Ministrave në saj të funksionit të tyre të rëndësishëm shtetëror një mbrojtje të veçantë ligjore. Duke e bazuar mbrojtjen ligjore të anëtarit të Këshillit të Ministrave me atë të deputetit, Kushtetuta i ka dhënë të njëjtin kuptim juridik imunitetit për këtë kategori funksionarësh.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, megjithëse i njeh anëtarit të Këshillit të Ministrave imunitetin, nuk përcakton me saktësi procedurën që duhet ndjekur dhe organin, i cili ka të drejtë të vendos në rastet e heqjes së imunitetit dhe dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale të këtyre funksionarëve.

Prandaj, për kërkesin del e domosdoshme interpretimi i nenit 103/3 të Kushtetutës dhe përcaktimi i procedurës dhe organit kompetent, që vendos për heqjen e imunitetit dhe dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale të anëtarit të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është deputet.

Për të interpretuar dispozitën e mësipërme, Gjykata Kushtetuese niset nga rregullimi konkret që parashikon neni 103/3 duke ju referuar nenit 73 dhe në tërësi konceptit, që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar për imunitetin e funksionarëve të lartë të shtetit.

Në disa dispozita të Kushtetutës jepet vetëm e drejta e gëzimit të imunitetit për një pjesë të funksionarëve të lartë të shtetit, por nuk parashikohet procedura që duhet ndjekur për heqjen e imunitetit. Janë ligjet përkatëse ato që parashikojnë dhe rregullojnë në mënyrë më të hollësishme këtë moment juridik. Rregulli i referimit të gëzimit të imunitetit për një pjesë funksionarësh të lartë është parashikuar në disa dispozita të Kushtetutës si në nenin 61/3, 154/5 dhe 165/2 të saj. Nga e njëjta referencë ligjore nuk bën përjashtim as anëtari i Këshillit të Ministrave, i cili sipas nenit 103/3 gëzon imunitetin e deputetit.

Meqenëse vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e barazon në aspektin substancial gëzimin e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave me imunitetin e deputetit, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se edhe procedura që ndiqet për heqjen e imunitetit të deputetit, e parashikuar në nenin 73 të saj dhe në nenin 173 e vijues të Rregullores së Kuvendit do të jetë e zbatueshme dhe për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është deputet.

Në kuptim dhe zbatim të dispozitave të sipërcituara Gjykata Kushtetuese konkludon, se dhënia



e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është i zgjedhur deputet, do të bëhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas procedurës ligjore që parashikohet edhe për heqjen e imunitetit të deputetit.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenin 124 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 71,72 dhe 79 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

## V E N D O S I:

Për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj anëtarit të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është i zgjedhur deputet, do të zbatohet e njëjta procedurë që parashikohet edhe për deputetin.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

Tiranë, më 23.06.2000  
Nr.30 i Regj Themeltar.  
Nr.38 i Vendimit

## V E N D I M “NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |
|------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Sabri Rrapi,     | Anëtar i““““                   |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i““““                   |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i““““                   |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i““““                   |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i““““                   |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i““““                   |
| Zija Vuci,       | Anëtar i““““                   |

Me sekretare Arbenka Lalica, në datën 10.05.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31 Akti, që u përket:

**KËRKUES:** Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar nga deputeti Spartak Braho

### **SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

## O B J E K T I

Interpretimin e nenit 73/2 të Kushtetutës.

BAZA LIGJORE : Neni 131 i Kushtetutës.

Nga përmbajtja e kërkesës del, se ky grup deputetësh i kërkon Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse gjykatat e zakonshme legjitimohen, t'i kërkojnë Kuvendit, autorizimin për ndjekje penale të deputetit kur ky akuzohet se ka kryer ndonjë prej veprave penale që ndiqen mbi ankim.

Për motivimin e kërkesës për interpretim, kërkuesi ka cituar nenin 173 të Rregullores së

Kuvendit, ku është parashikuar se kërkesa për marrjen e autorizimit që lejon ndjekjen penale ndaj deputetit, i dërgohet Kryetarit të Kuvendit nga Prokurori i Përgjithshëm.

## GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e pakës kërkuese dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N

Neni 148 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë i ngarkon organit të prokurorisë veç të tjerave edhe detyrën e ushtrimit të ndjekjes penale.

Megjithatë, nga krahasimi i kësaj dispozite me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, del se kjo kompetencë e prokurorit nuk shtrihet mbi të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Ai e ushtron atë për çështje që ndiqen kryesisht ose mbi ankim. Në çështje të tjera që kanë të bëjnë me vepra penale, të cilat përmenden në mënyrë taksative në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale dhe që është e nevojshme kërkesa e të dëmtuarit akuzues, fillimi i ndjekjes penale është në kompetencë të gjykatës. Për rrjedhojë, në qoftë se kësaj i dalin pengesa ligjore në këtë drejtim, është e detyruar vetë të marrë të gjitha masat për eliminimin e tyre.

I tillë është rasti, kur subjekt i këtyre veprave janë persona që në bazë të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë imunitet penal. Ndjekja penale kundër tyre nuk mund të fillojë pa autorizimin e organeve shtetërore kompetente, siç mund të jetë Kuvendi, për deputetët, ministrat dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese, për anëtarët e saj dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për gjyqtarët e rretheve dhe të apeleve.

Në këto raste, kërkesën pranë këtyre organeve për marrjen e autorizimit ka të drejtë ta bëjë vetëm gjykata, pa pasur nevojë për ndihmën ose ndërhyrjen e prokurorit. Sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, prokurori është i përjashtuar nga pjesëmarrja e fazës së hetimit paraprak të këtyre çështjeve. Këto vihen në lëvizje vetëm mbi kërkesën e të dëmtuarit akuzues dhe çdo veprim procedural që ka lidhje me këtë fazë, kryhet nga vetë gjykata.

Veç kësaj, edhe gjatë gjykimit të këtyre çështjeve, pozita procedurale e prokurorit është e një lloji të veçantë. Ai nuk është palë në debatin gjyqësor, që zhvillohet vetëm midis të pandehurit dhe të dëmtuarit akuzues. Pra, për këtë kategori veprash penale, ai është përjashtuar me ligj nga roli i tij si përfaqësues i akuzës dhe si autoritet që ushtron ndjekjen penale.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, në përgjigje të kërkesës për interpretimin e nenit 73/2 të Kushtetutës, del me këtë konkluzion: Gjykatat a e zakonshme, është i vetmi organ procedues për veprat penale që ndiqen mbi kërkesën e të dëmtuarit akuzues. Për këtë shkak, ajo ka të drejtë dhe është e detyruar me ligj t'i drejtohet drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësinë e prokurorit, të gjitha organeve kompetente, duke përfshirë edhe Kuvendin dhe t'iu kërkojë atyre sipas përkatësisë, autorizimin për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet, vetëm në rastet kur i dëmtuari akuzues, në bazë të neneve 59 e 284/5 të Kodit të Procedurës Penale, ushtron kërkesë për procedim.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të paragrafit të parë të nenit 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 71 e 79 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

### V E N D O S I:

Paragrafin e dytë të nenit 73 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ta interpretojë në këtë mënyrë:

Për çështjet e parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për marrjen në autorizim për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet, i drejtohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nga vetë gjykata pranë së cilës është depozituar kërkesa e të dëmtuarit akuzues.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

Tiranë, më 23.06.2000  
Nr.31 i Regj. Themeltar  
Nr.39 i Vendimit

## MENDIMI I PAKICËS

Pikëpamja ime është e kundërt me mendimin e shumicës. Kërkesa e një grupi deputetësh për të interpretuar nenin 73/2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nnuk lidhet me kompetencën e kësaj gjykate për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Kërkesa e tyre nuk ka të bëjë me kuptime të ndryshme interpretative që mund t'i jenë bërë dispozitës konkrete të Kushtetutës, pasi ata kërkojnë marrjen e një përgjigje nga Gjykata Kushtetuese për një çështje, e cila si rregull duhet të zgjidhet nga ligji.

Neni 73/2 i Kushtetutës jep konceptin e paprekshmërisë penale për deputetin pa patur një autorizim të Kuvendit, por nuk parashikon procedurën që ndiqet në këto raste. Fakti që ky nen kushtetutes nuk parashikon procedurën dhe organin që duhet t'i drejtohet Kuvendit për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj një deputeti për çështjet që ndiqen mbi ankimin e të dëmtuarit akuzues, nuk do të thotë se kjo çështje duhet të zgjidhet nëpërmjet interpretimit kushtetutes. Këtë problem normalisht duhet ta zgjidh vetëm ligji, që në rastin konkret është kodi i Procedurës Penale dhe Rregullorja e Kuvendit.

Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale si dhe Rregullorja e Kuvendit nuk e kanë zgjidhur çështjen e organit që kërkon dhënien e autorizimit për deputetin për çështjet që ndiqen mbi ankim. Ato parashikojnë se kërkesa për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për fillimin e ndjekjes penale i dërgohet Kryetarit të Kuvendit nga Prokurori i Përgjithshëm.

Në këto kushte mendoj se ndodhemi përpara një ometimi legjislativ, që do të thotë se ligji nuk ka parashikuar organin, apo subjektin që duhet të kërkojë në Kuvend dhënien e autorizimit për deputetin për çështjet që ndiqen mbi ankim.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj e ka interpretuar nenin 73/2 të Kushtetutës duke e tejkaluar kompetencën e saj, pasi ka vendosur se "...kërkesa për marrjen e autorizimit për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet i drejtohet Kuvendit nga vetë gjykata pranë së cilës është depozituar kërkesa e të dëmtuarit akuzues".

Ky interpretim i shumicës kam bindjen se nuk është i drejtë për dy arsye thelbësore:

Së pari: Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj duke ia njohur këtë të drejtë gjykatës së zakonshme, në një kohë që vetë Kushtetuta apo ligji nuk ja njohin këtë kompetencë, ka krijuar një normë të re juridike. Sipas nenit 124 të Kushtetutës, ajo bën interpretim përfundimtar të saj. Interpretimi nuk është dhe nuk mund të jetë krijim i normave të reja ligjore, por jep kuptimin e saktë e të rregullt të normave të shprehura në dispozitat ligjore në pajtim me parimet kushtetuese, duke marrë në konsideratë kuptimin e tyre gjuhësor, përmbajtjen sociale, historike, boshtin logjik, si dhe qëllimin e vet dispozitës.

Në vendimet interpretuese Gjykata Kushtetuese nuk shkon më tutje dhe nuk mund të shtojë asgjë në sistemin e normave detyruese ligjore. Ajo vetëm shpall ose pohon përmbajtjen e këtyre normave, zbërthen dyshimet interpretuese, duke eliminuar kontradiksin apo paqartësinë që mund të ekzistojë, pa shkelur parimet bazë të Kushtetutës dhe pa cënuar pavarësinë e organeve apo rolin që ato luajnë në sistemin e përgjithshëm të pushtetit shtetëror. Kështu interpretimi i kryer nga Gjykata Kushtetuese ka vetëm karakter "deklarativ", dhe jo natyrë ligjbërëse, pra nuk bën ligje. Pushtetet e ndara kushtetuese e detyrojnë Gjykatën Kushtetuese të veprojë kështu, duke e përjashtuar nga roli i ligjvënësit.

Së dyti: shumica me vendimin e saj i ka atribuar gjykatës së zakonshme një kompetencë, të cilën ajo jo vetëm që nuk e ka të parashikuar me Kushtetutë dhe me ligj, por njëkohësisht i ka cënuar dhe pozicionin si organ që realizon me paanshmëri dhënien e drejtësisë. Mospërcaktimi në nenin 73/2 të Kushtetutës i organit që kërkon dhënien e autorizimit pranë Kuvendit për fillimin e ndjekjes penale për deputetin për çështjet që ndiqen me ankim dhe ometimi që kanë Kodi i Procedurës Penale, apo

Rregullorja e Kuvendit në këtë drejtim, mendoj se nuk është argument për të konkluduar se kjo e drejtë duhet t'i përkasë patjetër gjykatës.

Sipas vendimit të shumicës "...fillimi i ndjekjes penale është në kompetencë të gjykatës" dhe ajo në gjykimin e çështjeve të tilla mund të ndryshojë pozicionin e saj, duke u bërë aktive në drejtim të marrjes së provave dhe "...është vetë e detyruar të marrë të gjitha masat për eliminimin..." e pengesave që lidhen me rrethanat që nuk fillojnë fillimin e çështjes penale.

Koncepti im për gjykatën është se kur asaj i paraqitet kërkesa nga i dëmtuari akuzues ndaj një deputeti nuk mund të ndryshojë pozitën e saj juridike duke u shndërruar në një organ procedues dhe të zëvendësojë prokurorin për të kërkuar dhënien e autorizimit në Kuvend për fillimin e ndjekjes penale, por mjaftohet me mosfillimin e çështjes penale.

Meqenëse ligji ka një boshllëk legjislativ për këto çështje dhe duke qenë se prokurori merr pjesë në çështje të tilla pjesëmarrje e cila mund të konsiderohet e detyrueshme, (dhe jo siç arsyeton shumica se prokurori është i përjashtuar nga pjesëmarrja gjatë fazës së hetimit paraprak të këtyre çështjeve) ai nuk mund të qëndrojë pasiv në proces dhe do të ishte më e pranueshme që këtë kërkesë ta realizonte ai. Edhe i dëmtuari akuzues i cili përfaqëson akuzën në këto çështje dhe që ka detyrimin të paraqesë në gjykatë të gjitha provat e nevojshme që lidhen me të akuzuarin ka një pozitë të tillë procedurale që mund të kërkojë çdo lloj të dhëne apo prove, qoftë edhe kërkesën për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për të akuzuarin. Ky është dhe kuptimi i një procesi të drejtë penal ku palët duhet të kenë të drejta të barabarta.

Me vendimin e shumicës duke ju lënë gjykatës bërja e kërkesës në Kuvend për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit, gabohet edhe në aspektin se ndërsa prokurori mund të thirret nga Komisioni i Mandateve dhe Imuniteteve për të dhënë sqarime për çështjet që fillon kryesisht, gjykata nuk mund të vihet në një pozitë të tillë. Për rrjedhojë kërkesën për dhënien e autorizimit pranë Kuvendit nuk e mbron dot organi që e ka kërkuar një gjë të tillë.

Përfundimisht, mendoj se formalisht ndodhemi përpara një ometimi legjislativ që nuk ka nevojë për interpretim kushtetues.

Megjithatë duke qenë i ndërgjegjshëm se gjykata e zakonshme nuk mund të refuzojë të zgjidhë çështjen konkrete kur i paraqitet për shqyrtim me argumentin se ligji mungon, jam i mendimit se i vetmi organ (por absolutisht nuk mund të jetë gjykata) që ka detyrimin ligjor për të bërë kërkesën në Kuvend për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj një deputeti për çështjet penale që ndiqen mbi ankim, pavarësisht se janë çështje që nuk ndiqen kryesisht, është dhe duhet të jetë prokurori.

Tiranë, më 23.06.2000

ANËTAR  
Sokol Sadushi

## V E N D I M NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

|                    |         |
|--------------------|---------|
| Thimjo Kondi,      | Kryetar |
| Bashkim Caka,      | Anëtar  |
| Agron Lamaj,       | "       |
| Natasha Sheshi,    | "       |
| Vangjel Kosta,     | "       |
| Petrit Piloçi,     | "       |
| Ylvi Myrtja,       | "       |
| Metush Saraçi,     | "       |
| Valentina Kondili, | "       |
| Vladimir Bineri,   | "       |

Zamir Poda, “  
Artan Hoxha, “  
Tefta Zaka, “  
Nikoleta Kita “

Në seancën gjyqësore të datë 11.5.2000 mori në shqyrtim çështjen civile nr.1516, që i përket:

**PADITËS:** Veip Jaçe

**I PADITUR:** Komisioni i ndarjes së tokës të fshatit, Qazim Pali

**PALA E TRETË:** Komuna Lukovë, Komisioni i ndarjes së tokës

**OBJEKTI I PADISË:** Detyrimin e anës së paditur të më trajtojë me tokë bujqësore, sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, si një e drejtë e njohur me ligj e që nuk mund të cënohet pa një proces të rregullt ligjor.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 42, ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, Kodi i Procedurës Civile, nenet 32, 41, 153.

Gjykata e rrethit Sarandë, me vendimin nr.547, datë 8.11.1999 ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr.85 datë 15.2.2000 ka lënë në fuqi këtë vendim të gjykatës së shkallës së parë Sarandë.

Kundër tyre është ushtruar rekurs në Gjykatë të Lartë nga paditësi i cili parashtrohet këto shkaqe për prishjen e vendimeve.

1. Kam që në vitin 1991 që merrem me të gjitha komisionet dhe akoma edhe sot mbas mbi 9 vjetësh nuk kam marrë asnjë zgjidhje për sa kërkoj.

2. Gjykatat kanë shpërfillur nenin 42 të Kushtetutës për të drejtën e individit për një proces të rregullt gjyqësor, pasi asnjëra prej tyre nuk e ka bërë atë, por më referojnë në organe të cilat nuk më kanë dhënë zgjidhje për një kohë kaq të gjatë.

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relacionet e gjyqtarëve Artan Hoxha dhe Metush Saraçi, prokurorin pranë Gjykatës së Lartë, Bujar Sheshi i cili kërkoj lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave, dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

#### V Ë R E J N Ë

Vendimi nr.547 datë 8.11.1999 i gjykatës së rrethit gjyqësor Sarandë që ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështjen, me arsyetimin se sipas V.K.M. nr.230, datë 22.7.1991, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet komisionit të tokës në fshat dhe individëve, është komisioni i tokës në rreth si dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, nr.85, datë 15.2.2000 që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë me të njëjtin arsyetim, janë të pa mbështetura në ligj e në fakt, e për këtë shkak duhet të prishen.

Në nenin 59/2 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet qartë, se Gjykata e Lartë është e vetmja gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankimit kundër vendimeve të gjykatave më të ulta, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor apo administrativ.

Në pjesën e tretë të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohen rregullat e përgjithshme të ankimit kundër vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit dhe atë të Lartë. Përveç rregullimit të përgjithshëm, në raste të rregulluara posaçërisht në Kod, përcaktohen edhe procedura të posaçme për ankimet kundër vendimeve gjyqësore. Një rast i tillë është edhe ankimi kundër vendimeve që disponojnë lidhur me juridiksionin dhe kompetencën. Kur ka një rregullim të tillë Kolegjet e Bashkuara tërheqin vëmendje se gjykatat duhet të zbatojnë rregullat e posaçme të përcaktuara nga vetë ligji dhe jo ato të përgjithshme.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë nuk duhej ta shqyrtonte çështjen, por në bazë të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile duhej të vendoste moskompetencën e saj dhe të dërgonte aktet në gjykatën kompetente që në këtë rast është Gjykata e Lartë. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në

konkluzionin se vendimi i dhënë nga kjo gjykatë është jo vetëm i kundraligjshëm, por është një vendim absolutisht i pavlefshëm që nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe si i tillë duhet të priset.

Çdo individ, pasi të ketë ezauruar rekursin administrativ, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me padi për detyrimin e organit administrativ për nxjerrjen e aktit administrativ brenda kompetencave të tij, me qëllim realizimin e një të drejte ligjore të pretenduar.

Gjatë gjykimit të çështjes provohet pretendimi i paditësit Veip Jaçe, i cili që në vitin 1991 i ka kërkuar komisionit të tokës së fshatit dhe më pas atij të komunës që sipas kompetencave të përcaktuara në ligjin nr.7501, datë 19.7.1991, të trajtohet me tokë bujqësore. Që nga ajo kohë, nga ana e këtyre organeve për më tepër se 9 vjet nuk është vepruar në zbatim të ligjit, duke mos i kthyer asnjë lloj përgjigje qoftë edhe negative lidhur me sa ai ka kërkuar dhe për këtë shkak paditësi i është drejtuar gjykatës. Gjykata duke vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes e kthen paditësin përsëri në gjendjen e mëparshme që t'i drejtohet përsëri atyre organeve prej të cilave nuk është vepruar deri tani.

Sipas ligjit për tokën të vitit 1991, toka bujqësore e ish kooperativave bujqësore u ndahet familjeve anëtare të cilët kthehen në pronarë të kësaj toke. Sipas nenit 24 të ligjit, krieteret për ndarjen, regjistrimin, vlerësimin e tokës, etj., caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Po në vazhdim ligji përcakton si organe kompetente për zbatimin e tij komisionet e ndarjes së tokës në fshat e komunë. Në zbatim të detyrimit ligjor, për ta bërë ligjin efektiv, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë akte nënligjore ku përcaktohen saktësisht mënyrat e funksionimit të komisioneve, kompetencat e tyre dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet komisioneve me individët. Që këtë rezultat se organi kompetent për ndarjen e kërkesat e individëve për tokë bujqësore, sasinë, vendin e të tjera. Ky organ është i detyruar në bazë të ligjit dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.230, datë 22.7.1991 t'u japë përgjigje të gjitha kërkesave të bëra duke vendosur pranimin e tyre por edhe refuzimin kur është rasti. Nga ana tjetër ky komision nuk ka të drejtë të refuzojë qëndrimin e tij lidhur me kërkesën e bërë duke mos nxjerrë edhe aktin përkatës. Pika 2 e vendimit në fjalë të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen detyrat e komisionit të tokës në rreth, parashikon ndër të tjera kompetencën e tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin ndërmjet komisionit të tokës në fshat me individët. Ky komision ashtu si edhe të tjerët, është i detyruar që në zbatim të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, të ushtrojë funksionet e tij duke marrë vendimet përkatëse dhe jo të heshtë lidhur me sa i kërkohej. Nga ana tjetër, në Kodin e Procedurave Administrative, në nenin 56, përcaktohet detyrimi që kanë organet administrative t'u njoftojnë personave të interesuar aktet administrative që merren lidhur me sa është kërkuar prej tyre.

Parë në këtë këndvështrim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se është e vërtetë se ndarja e tokës bëhet në rrugë administrative nëpërmjet komisioneve të ndarjes së tokës dhe se po në këtë rrugë administrative individët mund të kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në organin më të lartë që në rastin konkret është komisioni i tokës në rreth. Por nga ana tjetër është e drejta e individit dhe detyrimi i organeve administrative që të disponojnë lidhur me kërkesat e tyre, qoftë edhe duke mos i pranuar ato.

Nga objekti i padisë duket qartë se nga gjykata kërkohej të detyrohet ana e paditur, komisioni i tokës në fshat, të zbatojë kompetencat e tij të ngarkuara me ligj. Pra të detyrohet që të shqyrtojë kërkesën e paditësit lidhur me sa ai pretendon që të trajtohet me tokë bujqësore në fshat. Gjykata duke mos e vlerësuar drejt pretendimin e ngritur nga paditësi e ka konsideruar mosmarrëveshjen si një konflikt ndërmjet tij dhe të paditurit dhe duke iu referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.230, datë 22.7.1991 e ka konsideruar çështjen jashtë juridiksionit të saj. Gjykata në rastin konkret ka gabuar në objektin e gjykimit, pasi asaj nuk i është kërkuar që të pajisë paditësin me tokë bujqësore. Në këtë kuptim gjykata nuk ka juridiksion, pasi vetë ligji e aktet në zbatim të tij kanë përcaktuar juridiksionin administrativ të njohjes të së drejtës së pronësisë dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me to. Nga ana tjetër, gjykata duke mos pasur kompetencë në këtë drejtim, është plotësisht kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi e në veçanti të Kodit të Procedurave Administrative miratuar me ligjin nr.8485 datë 12.5.1999, neni 18/b dhe Kodit të Procedurës Civile të detyrojë organet administrative që të kryejnë funksionet e tyre kur ato nuk veprojnë sipas ligjit.

Gjykata e rrethit gjyqësor Sarandë në dhënien e vendimit të saj duhej t'i referohej nenit 331 të Kodit të Procedurës Civile i cili parashikon se gjykata ndër të tjera vendos detyrimin e organit administrativ të nxjerrë akte administrative në përputhje me kërkesat e ligjit. Në këtë këndvështrim

gjykata e shkallës së parë Sarandë ka qenë kompetente për shqyrtimin e padisë, ku në përfundim të gjykimit do të vendoste detyrimin e komisioneve përkatëse që të dispononin me akt administrativ lidhur me kërkesën e bërë nga paditësi Veip Jaçe.

Nisur nga sa u parashtrua, arrihet në konkluzionin se organet e mësipërme, jo vetëm që nuk kanë ushtruar detyrën duke i mohuar paditësit për një periudhë të gjatë kohe të drejtën lidhur me sa pretendon, por pas vendimit të gjykatës atij i është mohuar njëkohësisht edhe garancia kushtetuese për një gjykim të drejtë, sipas nenit 42 të Kushtetutës.

Për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se duhet të mbahet qëndrim i njëjtë lidhur me disponimin gjyqësor kur nga shqyrtimi i një çështje rezulton se organet e ngarkuara me detyra për zbatimin e dispozitave të caktuara ligjore, nuk i ushtrojnë funksionet e tyre. A ka juridiksion gjykata për të detyruar organin administrativ që:

1) t'i japë përgjigje kërkesës apo ankimit të paraqitur nga shtetasi përsa i kërkohet organit administrativ dhe,

2) përgjigja të jepet brenda kompetencave të organit, afatit të përcaktuar në ligj, apo në një afat të arsyeshëm kur nuk ka një të tillë të parashikuar.

Duke i çmuar nga këto detyrime Kushtetuese dhe ligjore, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin se gjykatës i lind e drejta, të detyrojë me vendim cilindo organ jo vetëm të ushtrojë detyrën, por ta ushtrojë atë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet duke garantuar të drejtën e individit për një gjykim të drejtë dhe në një afat të arsyeshëm.

Nisur nga sa më sipër, gjykata e shkallës së parë Sarandë duhej të shqyrtonte çështjen dhe të detyronte komisionin e tokës në fshat, apo atë të rrethit për të disponuar me akt administrativ lidhur me sa kërkohet nga paditësi.

## PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 485/ç të Kodit të Procedurës Civile,

## V E N D O S Ë N:

1. Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër Nr.85, datë 15.2.2000 dhe vendimit Nr.547, datë 8.11.1999 të gjykatës së rrethit gjyqësor Sarandë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim përsëri në atë gjykatë.

2. Ky vendim për njehsim të praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 11.05.2000

Nr.1516 i Regj. Themeltar

Nr.686 i Vendimit

KRYESUES: Th.Kondi

Anëtarë: N. Kita, A. Hoxha, V. Kondili, M. Saraçi, N. Sheshi, V. Bineri, V. Kosta, Z. Poda, Y. Myrtja, B. Caka, A. Lamaj, T. Zaka, P. Plloçi.

## K Ë R K E S Ë

**Kërkuuese:** Dhurata Reçaj, bija e Zijait, lindur më 1971 dhe banues në Shkodër, lagja “Partizani”, rruga “Fetah Barbullushi”, pall.1047, e martuar me dy fëmijë.

**Objekti:** Shpalljen të zhdukur të të quajturit Mehmet Reçaj.

**Baza ligjore:** Neni 375 e vijues të K.Pr.Civile.

Siç del edhe nga çertifikata bashkëngjitur kërkesës, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Shkodër, me të paditurin jemi bashkëshort dhe nga kjo martesë kemi edhe dy fëmijë të quajtur Eres

Mehmet Reçaj dhe Edis Mehmet Reçaj respektivisht të datëlindjeve 5.12.1991 dhe 27.4.1996.

Ka rreth 6 vjet që bashkëshorti im i quajtur Mehmet Reçaj është larguar jashtë shtetit në Greqi për të punuar dhe që nga ajo kohë edhe deri më sot ai nuk dihet se ku ndodhet, pra ne nuk kemi dijeni fare për gjendjen e tij.

Për të vërtetuar sa më sipër paraqes dy çertifikata, atë të lindjes së tij dhe atë të gjendjes familjare, si dhe një vërtetim të lëshuar nga Komisariati i Policisë Nr.1 Shkodër, datë 28.4.1998 nga ku del se megjithë kërkimet e tyre nuk është bërë e mundur gjetja e tij.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj që në rastin më të parë të shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe të provave bashkëngjitur saj të vendosni shpalljen të zhdukur të të quajturit Mehmet Reçaj, biri i Hasanit dhe Sherifes lindur më 20 shkurt 1962 në Gruemirë dhe banues në Shkodër.

Bashkëngjitur si prova fillestare paraqesim:

- 1) Çertifikatën e lindjes lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Shkodër datë 15.4.1998.
- 2) Çertifikatë familjare e datës 13.1.2000.
- 3) Vërtetim i lëshuar nga Komisariati i Policisë Shkodër datë 28.4.1998.

KËRKUESE  
**Dhurata Reçaj**

### K Ë R K E S Ë

**Kërkuese:** Lenine Troqe, e bija e Rexhep Cacaj, lindur më 1960 në Zhapokik të Tepelenës, banuese në Orikum, Vlorë, lagja 1 Maj, nr.50.

**Objekti:** Shpalljen si të vdekur të Shkëlqim Cacaj, në bazë të nenit 19 të K.C. dhe të nenit 388 të K.P.C.

Unë kërkuesja jam motra e të ndjerit Shkëlqim Cacaj, i cili ka humbur më datën 17.3.1988, në det, në një ditë peshkimi.

Ashtu si do ta vërtetoj edhe me dokumentet që po ju bashkëngjis, më datën 17.3.1988, i ndjeri Shkëlqim bashkë me burrin tim të ndjerin Sherif Troqe, kanë dalë në gjueti rreth orës 800 , me një lance të vogël peshkimi pronë e tyre private.

Për shkak të motit të keq, që në distancën rreth 100 metra, ky mjet lundrues është përmbysur dhe të dy personat kanë rënë në det.

Megjithë kërkimet e vazhdueshme për t'i gjetur në vendin e ngjarjes për shkak të fatalitetit nuk u gjet asnjëri. U fillua ndjekja penale, dhe vetëm pas 18 ditësh u gjet në breg të detit vetëm trupi i bashkëshortit tim Sherif Troqe, ndërsa deri më sot për vëllanë nuk dihet se ku është trupi i tij.

Në këto rrethana në bazë të nenit 19 të K.C., ne të afërmit të tij na lind e drejta për të shpallur si të vdekur ligjërisht vëllanë tonë të quajtur Shkëlqim Cacaj.

Për të vërtetuar përsa më sipër bashkëngjitur çertifikatën e gjendjes civile datë 5.4.2000 ku figuron i regjistruar në gjendjen civile Orikum.

Po kështu për efekt prove për të vërtetuar përsa më sipër, bashkëngjitur shkresën Nr.674, datë 6.4.2000 të Prokurorisë së rrethit Vlorë, e cila vërteton ngjarjen dhe vërtetimi i datës 6.4.2000, Nr.240 i Bashkisë Orikum ku vërtetohet ngjarja, moti i keq, dhe se edhe pse u kërkua nga të afërmit e tij që në moment nuk u gjend.

Ditën e gjykimit do të sjell edhe prova me dëshmitarë.

Lutemi të çelet një seancë gjyqësore ku të shpallet vdekja e vëllait tim Shkëlqim Cacaj me datë 17.3.1988.

KËRKUESE  
**Lenina Troqe**

### K Ë R K E S Ë



**Kërkuese:** Hike Shahini, e bija e Demirit dhe e Lutfijes, lindur më 1961 në Koms-Mat, banuese në rrugën “Lord Bajron”, Laprakë.

**Objekti:** Shpalljen të vdekur të bashkshortit tim Xhemal Ahmet Shahini

**Baza ligjore:** Neni 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 15 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

Unë kërkuesja, jam bashkëshortja e Xhemal Ahmet Shahini dhe kemi tre fëmijë Adnandin, Andin e Julianin.

Xhemali është i biri i Ahmetit dhe i Nafijes, lindur në Fullqet të rrethit Mat, i datëlindjes 22 maj 1952 dhe banues në Tiranë me adresën e mësipërme.

Ka punuar në degën e shfrytëzimit të automjeteve në Laç. Më datën 28 maj 1997, Xhemali është larguar nga shtëpia. Po në këtë ditë duke u kthyer për në shtëpi rreth orës 1500 jemi njoftuar se është marrë forcërisht nga disa persona të armatosur, të cilët i kishin zënë pritë në rrugën Laç-Burrel, në zonën e quajtur Skuraj. Nga kjo ditë nuk kemi asnjë lajm për të, megjithëse jemi interesuar vazhdimisht.

Kemi bërë denoncim në Prokurorinë e rrethit Kurbini (Laç) dhe përsëri nuk ka ndonjë lajm të ri për të.

Të gjitha kërkimet tona janë bërë në rrugë private dhe shtetërore e deri tani kanë qenë pa rezultat duke mos marrë asnjë lajm të ri.

Nga sa përshkruam ngjarjen dhe rrethanat del më se e qartë dhe e besueshme se bashkëshorti im Xhemal Shahini ka vdekur.

Në këtë rast kërkojmë të përcaktohen trashëgimtarët e radhës së parë. (Kjo sipas nenit 376 të K.Pr.C.) ku trashëgojmë nga 1/4 pjesë secili dhe jemi:

1. Hike Demir Shahini bashkëshortja e tij
2. Adnand Xhemal Shahini i biri.
3. Andi Xhemal Shahini i biri
4. Julian Xhemal Shahini i biri

Në seancat e gjyqimit do të paraqesim provat e nevojshme si certifikata dhe vërtetimin e Prokurorisë së Laçit për çështjen penale të hapur “Rrëmbim personi”.

Duke qenë se në këto rrethana i kërkujmë gjykatës të shpallet i vdekur bashkëshorti im Xhemal Ahmet Shahini si dhe të përcaktohen trashëgimtarët e radhës së parë.

KËRKUESE  
Hike Shahini

## K Ë R K E S Ë

**Kërkuese:** Behare Aliaj, e bija e Shaqes dhe e Tekiut, lindur më 1955 në Çorushë të Mallakastrës dhe banuese në Vlorë me adresën, lagja “29 Nëntori”, rruga “Lef Sallata”, pallati 1103, ap.9, bashkëshortja e Petrit Alias.

**Objekti:** Shpallja të vdekur të Petrit Aliaj në bazë të nenit 19 të Kodit Civil dhe nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenit 31 e vijues të K.P.C.

Unë, bashkëshortja e z. Petrit Aliaj, i cili siç provohet nga një sërë provash të cilat unë do t'i bëj prezente në seancë gjyqësore, është mbytur më 08.10.1993, datë në të cilën humbën jetën gjithë anëtarët e ekuipazhit të anijes “Jon” me përjashtim të njërit, që mundi të shpëtonte nga kjo fatkeqësi natyrore.

Pas vdekjes së tim shoqi, trashëgimtarë mbetëm unë dhe tre fëmijët, por që dëshminë e trashëgimisë për përcaktimin ligjor të trashëgimtarëve nuk e kemi nxjerrë akoma.

Meqenëse nga shpallja e vdekjes së bashkëshortit tim varen një sërë interesa të familjes sonë do t'ju drejtohem Juve me këtë kërkesë.

Ditën që do të zhvillohet seanca gjyqësore unë do të vendos gjithë dokumentacionin e nevojshëm si dhe do të sjell dëshmitarët për të vërtetuar pretendimet e mia.

Lutemi caktoni një ditë për zhvillimin e seancës gjyqësore.

KËRKUESE  
Behare Aliaj

### K Ë R K E S Ë

**Kërkuese:** Sheqere Koçi e bija e Abdurrahimit dhe e Vahide lindur më 1951 në Peshkopi, banuese në Tiranë në rrugën “Vllazën Huta” nr.16.

**Objekti:** Kërkoj shpalljen e vdekjes të Vahide Koçit.

**Baza ligjore:** Neni 375 të Kodit të Procedurës Civile

Unë kërkuesja Sheqere Koçi, në bazë të certifikatës së trungut familjar, jam e bija e të ndjerës Vahide Koçi. Theksoj se mamaja ime ka vdekur më datë 28 shkurt 1985 në fshatin Lejcan të rrethit të Peshkopisë, e cila kishte vajtur për të parë djalin e saj që jetonte atje. Për shkak të kohës së keqe ceremonia e varrimit iu bë në fshat. Nga verifikimet që kemi bërë në Gjendjen Civile të Njësisë nr.2 në Tiranë, rezulton se e ndjera Vahide Koçi nuk ka vdekur por është e gjallë. Këtë e vërtetojmë në bazë të certifikatës së lindjes, e cila është marrë nga Zyra e Gjendjes Civile.

Prandaj në këto kushte po i drejtohem gjykatës me anën e kësaj kërkesë për shpalljen të vdekur të së ndjerës Vahide Koçi në bazë të nenit 375 të K.Pr.Civile.

Bashkëngjitur kësaj kërkesë do t’iu paraqesim dhe provat e nevojshme si dhe dëshmitarët për këtë çështje.

KËRKUESJA  
Sheqere Koci

U dorëzua për shtyp më 7.7.2000  
Doli nga shtypi më 11.7.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë